

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I FINANCËS
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 5303.....Prot

Tiranë, më 31/09/2022

Lënda: Kërkesë për aplikim për Tarifën e Transmetimit të Energjisë Elektrike për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
Adresa: Blvd. Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023

I nderuar Z. Ahmeti,

Në përputhje me (i) Ligjin nr. 43/2015 dt. 30.4.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektike", (ii) Metodologjinë e Llogaritjes së tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike, OST ka përgatitur "Përlllogaritjen e Tarifës për vitin kalendarik 2023 dhe periudhën 2023-2025".

OST sh.a në llogaritjen e tarifës së transmetimit për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025, ka ndjekur me rigorozitet të drejtat dhe detyrat që ajo ka në referencë te ligjit 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektike", nenet 55, 56, 60, 61, 62, 65 dhe 66, si dhe neni 2 i "Metodologjia e Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike".

Në referencë të ligjit të sipërcituar, neni 55, pika 1, jeni të lutur që të merrni në shqyrtim dhe të konsideroni materialin tonë për aplikimin e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për OST për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025.

Në mbështetje të kësaj kërkesë, bashkëlidhur do të gjeni:

- *Relacioni sqarues për llogaritjen e tarifës;*
- *Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë së OST sh.a., për periudhën Janar - Qershor 2022;*
- *Vlerësimet Financiare të Biznes Planit të OST sh.a. për vitet 2023-2025;*
- *Gjëndja e Huave Afatgjata të OST sh.a., dhe kostot e tyre për periudhën 2023-2025;*
- *Lista e llogarive të OST sh.a..*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I OST sh.a.

Skërdi Drenova

RELACION

**PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

PËR VITIN 2023 DHE PERIUdhËN 2023-2025

Përmbajtja

I.	Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.	3
II.	Qëllimi i propozimit për rishikimin e tarifës së transmetimit.	4
III.	Raport i aktivitetit të OST sh.a. për Periudhën Janar-Qershor 2022	4
IV.	Pritshmëria e realizimit të treguesve për vitin 2022	5
V.	Parashikimi i kërkesës për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025	9
VI.	Llogaritja e tarifave të transmetimit për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025	13
A.	Kostot kapitale	14
VII.	Parshikimi i Investimeve për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025	14
VII.1	Projektet e Investimeve me fonde të huaja	15
VII.2	Projektet e Investimeve me fonde të OST	16
B.	Kostot operuese	43
C.	Të ardhurat nga aktivitete të tjera	48
VIII.	Tarifa aktuale	48
IX.	Llogaritja e Tarifave	49
IX.1	Llogaritja e Tarifës me një nivel - Tarifa mesatare e transmetimit	50
IX.2	Llogaritja e Tarifës me dy nivele - Ndarja e kostove në kapacitet dhe energji	51
i.	Pagesat e kapacitetit	51
ii.	Pagesat e energjisë	52
X.	Konkluzionet dhe efektet	53

I. Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. ('Shoqëria'), një Shoqëri publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit. Shoqëria u krijua në Korrik të vitit 2004 bazuar në Vendimin nr. 797 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, datë 4 dhjetor 2003. Në bazë të këtij vendimi Shoqëria u themelua si rezultat i ndarjes nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare Sh. a ("KESH") me kapitali fillestar prej 2,000 mijë Lekë. Ndarja nga KESH u krye bazuar në pasqyrën e pozicionit financiar të datës 30 qershor 2006. Shoqëria përgatiti pasqyra financiare si një njësi ekonomike e veçantë duke filluar prej 1 korrik 2006 dhe jo prej vitit 2004 kur nisën të kryheshin transaksionet e para të Shoqërisë. Në vitin 2006 Shoqëria mori licencën për transmetim energjie nga Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri dhe në vijim nënshkroi një marrëveshje për shërbime transmetimi me KESH Bazuar në urdhrin nr. 329 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes ('Ministria') datë 9 maj 2008, pronësia e OST iu transferua Ministrisë. Me anë të urdherit numer 10540/17 të Ministrisë, Shoqëria, prej datës 1 janar 2008 filloi të faturonte shërbimet e saj, aktivitetet e cili me parë kryhej nepërmjet KESH.

Shoqëria aktualisht e ushtron aktivitetin e saj nepërmjet 6 Njësive Operative (me qendër në Shkodër, Burrel, Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë), Njësia e Mirëmbajtjes së Transmetimit (me qendër në Tiranë) dhe Administrata Qëndrore e cila është edhe selia e shoqërisë me adresë Autostrada Tiranë – Durrës, Km 9 Yrshek Kashar, Tiranë, Shqipëri.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike. OST, është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Me Vendimin nr. 12 datë 08.09.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., si dhe me Vendimin nr. 130 datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratuan pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar; si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.

Në datën 05 Tetor 2020, përfaqësuesit ligjorë të OST sh.a. dhe KOSTT sh.a., firmosën Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX.

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX, është regjistruar tashmë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë me NIPT M02223006B. Objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është krijimi, menaxhimi dhe administrimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike, nepërmjet platformes së tregut në baze të ditës në avance dhe Brenda të njejtës dite.

II. Qëllimi i propozimit për rishikimin e tarifës së transmetimit.

Ky aplikim, ka për qëllim të pasqyrojë nevojën për rishikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, tarifë e cila do të bëjë të mundur ushtrimin e aktivitetit normal të Operatorit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike synon të mbledhë të ardhurat e nevojshme për të zhvilluar investimet e nevojshme në sistem, për të mbuluar kostot operative të drejtimit të shoqërisë si dhe për të minimizuar humbjet në rrjetin e transmetimit.

Tarifa e transmetimit synon të shlyejë kostot e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Pronësinë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kablllove, nënstacioneve, transformatoreve, qendrave dispeçer dhe ndërtesave që lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese të OST-së që nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të transmetimit.
- c) Kostot e shërbimeve të tjera ndihmëse të OST-së, përfshirë pagesat e bëra OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të çastit dhe pagesat (nëse ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që duhen alokuar në një pagesë për energjinë reaktive.
- e) Kostot për të siguruar zyra, komunikim dhe facilitete të Teknologjisë së Informacionit (IT) për Operatorin e Tregut plus kostot e personeli që lidhen me Operatorin e Tregut. Nga këndvështrimi kontabël Operatori i Tregut duhet të këtë llogaritë e tij, sikur të ishte një njësi ligjore e pavarur me të ardhura të tatueshme më vete.
- f) Pagesat e detyrimeve që vijnë nga të gjitha huatë e marra për zhvillimin e rrjetit të transmetimit.
- g) Do të mbulojë kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit si dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse e të balancimit të prokuruar në treg.

III. Raport i aktivitetit të OST sh.a. për Periudhën Janar-Qershor 2022

Referuar Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a., për vitin 2022, të miratuar së pari me Vendimin Nr. 19, datë 17.12.2020 të Këshillit Mbikqyrës së OST sh.a., si dhe miratuar me shkresën Nr. 23839/4, date 27.01.2021 të MFE, OST sh.a. ka vijuar ushtrimin e aktivitetit të vet në funksion të plotësimit e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

Raporti i Ecurisë së Veprimtarisë së OST sh.a., për periudhën Janar - Qershor 2022, gjendet Raport më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

IV. Pritshmëria e realizimit të treguesve për vitin 2022

Viti 2022 filloi me një kuotë rreth 275 metra në liqenin e Fierzës, një kuotë jo shume e favorshme për ruajtjen e një niveli normal të sigurisë së furnizimit. Prurjet e tre muajve të parë të vitit ishin gjithashtu më të vogla se prurjet llogaritëse me 75% siguri. Situata e rezervës energjetike në kaskade u përmiresua kryesisht gjatë muajit prill dhe maj, ku prurjet rezultuan me të mëdha se ato llogaritëse, duke bërë edhe normalizimin e situatës energjetike të kaskadës.

Kapaciteti transmetues ndërkuftar ka qënë mëse i mjaftueshem për realizimin e kontratave të importit, eksportit, si edhe për realizimin e tranziteve sipas kapaciteteve transmetuese përkatëse të alokuara nga zyra rajonale CAO.

Bazuar në të dhënat e deritanishme dhe në parashikimin për muajt e ardhshëm, pritet që gjenerimi i vendit që injektohet në rrjetin e transmetimit të jetë rreth 6 TWh, shkëmbimi total (import) rreth 2 TWh, konsumi (tërheqja nga rrjeti i transmetimit) rreth 7.9 TWh përfshirë humbjet në rrjetin e transmetimit me rreth 205 GWh.

Në tabelën e mëposhtme jepen treguesit kryesorë të Prodhimit, Shkëmbimit dhe Konsumit për vitin 2022 (periudha Janar – Korrik me vlerat e realizuara, pjesa tjetër me vlerat e pritëshme).

Viti 2021	Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Prurja ne Fierze, me 75% siguri	m3/s	148	169	177	232	194.75	112	58	41	50	63	110	169	127
Prurja ne Fierze, faktike	m3/s	137	111	97	360	204	96	50	45	50	65	115	170	125
Kuota ne Fierze ne fillim te muajit	m	275.1	270.7	268.0	260.7	282.5	289.0	287.7	281.2	274.2	270.0	269.5	273.7	
Kuota ne Fierze ne fund te muajit	m	270.7	268.0	260.7	282.5	289.0	287.7	281.2	274.2	270.0	269.5	273.7	279.5	
Diferenca mesatare ditore	cm	-14.4	-9.7	-23.5	72.8	21.0	-4.5	-20.9	-22.5	-14.2	-1.5	14.0	18.8	1.3
Prodhimi ne Fierze	GWh	137.8	83.1	112.3	4.3	46.5	86.3	133.6	122.4	79.0	47.4	29.4	45.7	928
Prodhimi ne Koman	GWh	185.1	132.4	171.4	114.4	109.7	104.4	139.0	125.1	88.5	108.2	116.0	139.3	1,534
Prodhimi ne V.Dejes	GWh	92.7	68.0	84.2	66.9	51.0	48.0	64.4	62.5	44.6	62.2	67.2	85.2	797
Prodhimi ne Ashta	GWh	24.1	18.1	21.8	18.2	13.8	12.1	15.6	11.3	8.0	11.2	12.1	15.3	182
Prodhimi i Kaskades	GWh	439.7	301.6	389.6	203.9	221.1	250.9	352.6	321.3	220.2	228.9	224.7	285.5	3,440
Prodhimi ne HEC e Tjere	GWh	297.6	221.8	204.8	424.0	297.2	96.8	75.0	67.0	64.8	85.6	122.4	219.5	2,177
Prodhimi ne TEC	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Prodhimi i vendit	GWh	737	523	594.5	627.9	518.3	347.7	427.6	388.3	285.0	314.5	347.1	505.0	5,616
Konsumi i mujor	GWh	777.0	684.2	735.9	599.8	555.6	587.2	643.9	685.9	573.0	612.1	635.1	802.6	7,892
Konsumi mesatar ditore	GWh	25.1	24.4	23.7	20.0	17.9	19.6	20.8	22.1	19.1	19.7	21.2	25.9	21.6
Importi mujor	GWh	40	161	141	-28	37	239	216	298	288	298	288	298	2,276
Importi mesatar ditore	GWh	1.3	5.7	4.6	-0.9	1.2	8.0	7.0	9.6	9.6	9.6	9.6	9.6	6.2
Diferenca nga planifikimi mujor	GWh	10.6	28.7	43.4	-44.9	-24.1	-7.3	-39.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-2.7
Diferenca nga planifikimi ditore	GWh	0.3	1.0	1.4	-1.5	-0.8	-0.2	-1.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-0.1
Konsumi i planifikuar, mujor	GWh	766	655	693	645	580	594	683	686	573	612	635	803	7,925
Konsumi i planifikuar, ditore	GWh	24.7	23.4	22.3	21.5	18.7	19.8	22.0	22.1	19.1	19.7	21.2	25.9	21.7

Duke marrë në konsideratë parashikimet më të fundit për periudhën e mbetur të vitit, parashikohet që Bilanci Energjetik për vitin 2022 të jetë si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Realizim								Parashikim				Viti 2021
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	929	762	877	755	689	712	875	791	659	762	731	903	9,445
a)	Prodhim vendas	"	737	523	594	629	518	347	427	388	286	314	348	505	5,616
b)	Energji ne marrije	"	192	239	283	126	171	365	448	403	373	448	383	398	3,829
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	911	747	863	730	672	699	858	773	644	746	712	884	9,239
a)	Energji elektrike e dhene	"	152	78	142	154	134	126	232	105	85	150	95	100	1,553
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	716	607	645	490	451	492	571	578	474	501	512	659	6,696
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	43	62	75	87	86	81	55	90	85	95	105	125	990
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit														
a)	Humbjet ne GWh	GWh	18	15	15	25	17	13	17	18	15	16	18	19	207
b)	Humbjet ne %	%	1.94%	1.95%	1.69%	3.26%	2.52%	1.82%	1.97%	2.28%	2.30%	2.09%	2.53%	2.15%	2.19%

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të pritshme për vitin 2022

Gjatë ecurisë së aktivitetit të OST sh.a., për realizimin e objektivave dhe treguesëve kryesorë të kompanisë, duke marrë në konsideratë:

- Miratimin e tarifës së transmetimit e cila i fillon efektet duke nisur nga muaji Maj 2022;
- Efektet e përlllogaritura sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.456, datë 29/06/2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përsa i takon kostove të blerjes së humbjeve për periudhën e parashikuar nga ky vendim;
- Dinamikën e ecurisë së çmimeve të energjisë elektrike për blerjen e humbjeve;
- Realizimin e treguesve ekonomiko-financiar gjatë periudhës Janar-Qershor 2022 si dhe parashikimet më të përditësuara për periudhën e mbetur të vitit 2022;
- Menaxhimin sa më efikas të fondeve dhe arritjen e objektivave kryesore të OST sh.a., të cilat kanë të bëjnë me besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit të transmetimit;

nga ana e OST sh.a. është bërë një analizë në lidhje me prioritetet dhe efektivitetin e fondeve të programuara më parë për vitin 2022.

Në tabelën e mëposhtme, pasqyrohet rezultati financiar i pritshëm për vitin 2022.

	Njësia Matëse	Janar-Qershor 2022		I pritshmi Viti 2022	
		Plan	Fakt	Plan	I pritshmi
Të ardhurat					
Furnizuesit e kualifikuar	Mln lekë	427.5	355.2	953.6	826.9
OSHEE sh.a.	"	2,446.5	2,635.4	5,338.1	5,436.0
Tranzit Energjie	"	0.0	0.0	0.0	0.0
Te ardhura nga Transmetimi	Mln lekë	2,874.0	2,990.7	6,291.6	6,262.9
Alokimi i kapaciteteve	"	690.0	970.6	1,380.0	1,475.0
Te ardhura nga tregu i balancimit	"	0.0	1,516.9	1,204.4	1,616.9
Te ardhura nga telekomunikacioni	"	25.0	17.9	50.0	35.8
Të ardhura nga Grantet	"	25.0	53.6	50.0	63.6
Të ardhura te tjera	"	2.5	7.7	5.0	10.2
Total të ardhura Operative	Mln lekë	3,616.5	5,557.4	8,981.0	9,464.4
Total të ardhura Financiare	Mln lekë	0.0	177.9	0.0	177.9
TOTAL TE ARDHURA	Mln lekë	3,616.5	5,735.2	8,981.0	9,642.3
Shpenzimet					
Personeli	Mln lekë	648.8	605.8	1,372.6	1,329.6
Materiale të para	"	66.0	37.3	132.0	103.3
Furniturat dhe Shërbimet	"	261.3	145.1	467.7	351.5
Blerja e shërbimeve ndihmese	"	854.2	246.1	955.1	906.1
Blerja e humbjeve	"	1,841.4	2,314.0	4,196.0	4,196.0
Pagesë ITC	"	125.0	0.0	250.0	250.0
Pagesë për organizmat rajonale e europianë	"	75.0	81.1	105.0	111.1
Shpenzime per eksperte dhe vleresues	"	10.0	11.4	20.0	20.0
Pagesa për Ndermarrjet, Vendim Asambleje	"		54.5	54.5	54.5
Taksa	"	2.8	3.7	6.0	6.0
Gjoha dhe demshperblime	"		12.5	0.0	12.5
Amortizimi	"	1,343.1	1,183.0	2,686.2	2,251.5
Total shpenzime Operative	Mln lekë	5,227.6	4,694.5	10,245.1	9,592.0
Rezultati Operativ	Mln lekë	-1,611.1	862.9	-1,264.1	-127.6
Shpenzime për interesa	Mln lekë	308.0	228.1	616.0	524.7
Humbje nga kurset e këmbimit dhe te tjera	"		1.5	0.0	1.5
Total shpenzime Financiare	Mln lekë	308.0	229.5	616.0	526.1
TOTAL SHPENZIME	Mln lekë	5,535.5	4,924.0	10,861.1	10,118.1
Fitimi para tatimit	Mln lekë	-1,919.0	811.2	-1,880.0	-475.8
Tatim fitimi	Mln lekë	0.0	123.5	0.0	0.0
Fitimi/Humbja NETO	Mln lekë	-1,919.0	687.7	-1,880.0	-475.8

Kostot e blerjes së energjisë për humbjet për vitin 2022

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2022, OST sh.a. është përballur me një rritje të konsiderueshme të kostove për blerjen e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, të cilat reflektojnë nivele më të larta sesa parashikimet. Efektet e kësaj rritje të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare, kanë patur një ndikim të ndjeshëm dhe në kostot e sigurimit të tyre nga ana e OST sh.a., duke krijuar vështirësi të mëdha financiare për shoqërinë.


Gjatë periudhës Janar - Qershor 2022, nga OST sh.a., janë prokuruar 72,284 MWh energji elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim me një çmim mesatar rreth 263.69 EUR/MWh nga 149.44 EUR/MWh që ishte parashikuar, duke sjellë në këtë mënyrë një rritje të këtyre kostove me rreth 8.3 milionë EURO nga sa ishte parashikuar për këtë periudhë.

Vlera e shpenzuar për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 19 milion Euro.

PERIUDHA	Sasia MWh	Vlera Euro	Çmimi (EUR/MWh)
Janar	14,270.00	3,681,820.20	258.01
Shkurt	15,648	3,669,592	234.51
Mars	16,507	5,547,382	336.06
Prill	9,842	2,343,658	238.13
Maj	9,480	2,170,216	228.93
Qershor	6,537	1,647,627	252.05
TOTAL	72,284.00	19,060,295.22	263.69


Trendi i çmimeve të energjisë elektrike gjatë vitit 2022, deri me datë 31.08.2022 tregohet në grafikun e mëposhtëm:

Çmimet mesatare ditore në bandë, HUPX (EUR/MWh)



Siç tregohet ne grafik, çmimet e energjisë elektrike në treg gjatë vitit 2022, janë ndjeshëm më të lartë sesa ato të vitit të kaluar.

Në grafikun e mëposhtëm tregohen çmimet e blerjes së humbjeve të energjisë nga ana e OST sh.a. gjatë viteve 2019, 2020, 2021 dhe Janar-Qershor 2022. Periudha Nëntor - Dhjetor 2021, pasqyron parashikimet për çmimin e blerjes së humbjeve.



Duke marrë në konsideratë:

- Realizimin Faktik të prokurimit të energjisë elektrike për humbjet në periudhën Janar-Qershor 2022;
- Për periudhën Korrik-Nëntor 2022 – efektet e VKM Nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i cili parashikon sigurimin e humbjeve të energjisë elektrike në transmetim nga ana e KESH sh.a. me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, çmim i cili për vitin 2022 sipas Vendimit të ERE Nr. 253, datë 21.12.2021 është 8.5652 lekë/kWh;
- Për muajin Dhjetor 2022, një çmim tregu të energjisë rreth 510.68 EUR/MWh;

kosto totale e blerjes së Humbjeve për Vitin 2022, pritet të jetë rreth 35.14 milionë Euro ose 4,196 milionë lekë. Çmimi mesatar i blerjes së humbjeve për vitin 2022, pritet të jetë 202.01 EUR/MWh nga 149.44 EUR/MWh që ishte parashikuar në fillim të vitit.

Për vitet 2023,2024 dhe 2025, nga ana e OST sh.a. janë bërë parashikimet për çmimin e blerjes së humbjeve në një vlerë 559.72 EUR/MWh gjatë 2023; 334.12 EUR/MWh gjatë 2024 dhe 221.60 EUR/MWh gjatë 2025.


Vlerësimet Financiare të Biznes Planit të OST sh.a. për vitet 2022-2025, gjenden aneks më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

V. Parashikimi i kërkesës për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025

Mbi bazën e të dhënave historike për dhjetë vitet e fundit te konsumit mesatar ditor për cdo muaj, rezulton se gradienti mesatar i rritjes së kërkesës për energji elektrike, që transmetohet nëpërmjet rrjetit për OSSH dhe konsumatorët e lidhur në rrjetin e transmetimit është rreth 1%, sic paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti ↓ / muaji →	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
2012	24,358	23,940	19,626	19,506	17,487	18,138	19,581	19,895	18,449	17,861	20,088	25,252	
2013	25,170	24,999	22,871	19,289	17,938	18,928	19,673	19,731	18,267	18,790	21,346	26,372	
2014	24,686	23,420	21,833	20,182	18,152	18,023	18,657	19,991	18,502	19,512	20,195	22,104	
2015	22,173	20,912	19,248	16,710	16,558	16,893	18,766	19,010	17,174	15,677	17,955	21,512	
2016	21,616	18,688	18,121	15,897	16,016	15,722	17,443	17,847	16,270	16,458	18,600	23,104	
2017	24,259	20,737	18,514	17,819	16,817	18,341	19,251	19,889	17,269	17,901	20,088	22,340	
2018	21,841	22,339	20,833	17,696	17,175	17,678	18,655	20,039	17,972	17,896	19,710	23,912	
2019	24,237	21,447	19,915	18,634	17,790	18,826	19,752	20,954	18,076	16,781	17,933	21,668	
2020	23,573	21,873	19,411	16,436	16,212	17,310	19,146	19,597	18,544	18,387	20,985	23,726	
2021	24,592	23,367	22,310	21,435	18,387	19,517	21,981	22,852	19,341	19,436	21,066	25,151	
2022	25,065	24,385	23,769	19,994	17,923	19,571	20,771						
													Mesatare
Rritja2012/2013	3.3%	4.4%	16.5%	-1.1%	2.6%	4.4%	0.5%	-0.8%	-1.0%	5.2%	6.3%	4.4%	3.7%
Rritja2013/2014	-1.9%	-6.3%	-4.5%	4.6%	1.2%	-4.8%	-5.2%	1.3%	3.8%	-5.4%	-16.2%	-2.7%	-2.7%
Rritja2014/2015	-10.2%	-10.7%	-11.8%	-17.2%	-8.8%	-6.3%	0.6%	-4.9%	-7.2%	-19.7%	-11.1%	-2.7%	-9.2%
Rritja2015/2016	-2.5%	-10.6%	-5.9%	-4.9%	-3.3%	-6.9%	-7.1%	-6.1%	-5.3%	5.0%	3.6%	7.4%	-3.0%
Rritja2016/2017	12.2%	11.0%	2.2%	12.1%	5.0%	16.7%	10.4%	11.4%	6.1%	8.8%	8.0%	-3.3%	8.4%
Rritja2017/2018	-10.0%	7.7%	12.5%	-0.7%	2.1%	-3.6%	-3.1%	0.8%	4.1%	0.0%	-1.9%	7.0%	1.2%
Rritja2018/2019	11.0%	-4.0%	-4.4%	5.3%	3.6%	6.5%	5.9%	4.6%	0.6%	-6.2%	-9.0%	-9.4%	0.4%
Rritja2019/2020	-2.7%	2.0%	-2.5%	-11.8%	-8.9%	-8.1%	-3.1%	-6.5%	2.6%	9.6%	17.0%	9.5%	-0.2%
Rritja2020/2021	4.3%	6.8%	14.9%	30.4%	13.4%	12.7%	14.8%	16.6%	4.3%	5.7%	0.4%	6.0%	10.9%
Rritja2021/2022	1.9%	4.4%	6.5%	-6.7%	-2.5%	0.3%	-5.5%						-0.2%
Mesatare	0.5%	0.5%	2.4%	1.0%	0.4%	1.1%	0.8%	1.8%	0.6%	1.4%	0.9%	0.3%	1.0%
													Trend
													1%

Konsumi mesatar ditor në MWh



Duke pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST për konsum, të jetë e rendit 1% , dhe duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të cdo muaji, është bërë parashikimi i volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nëpërmjet rrjetit të transmetimit për vitin 2023, si në tabelën e mëposhtme:

Muaji		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Mujore	GWh	782	687	741	605	580	594	687	690	577	612	639	806	8,000
Mesatare ditore	MWh	25,235	24,535	23,915	20,155	18,700	19,815	22,155	22,245	19,235	19,745	21,290	26,010	
Ora / Ditë→		31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	
1	MW	715	720	700	635	600	640	725	725	610	555	600	745	
2	MW	620	635	620	575	555	585	660	665	555	495	565	660	
3	MW	575	595	590	550	535	560	635	635	535	480	545	615	
4	MW	560	575	580	570	535	550	620	620	535	470	535	610	
5	MW	565	585	590	580	540	560	620	625	535	495	555	620	
6	MW	620	645	655	595	575	595	655	660	570	565	635	695	
7	MW	775	820	820	705	680	700	750	755	685	730	800	885	
8	MW	1,020	1,075	1,055	875	815	830	880	885	795	900	975	1,135	
9	MW	1,190	1,200	1,155	950	885	905	980	985	880	950	1,015	1,255	
10	MW	1,250	1,215	1,165	960	910	935	1,030	1,035	920	940	1,000	1,255	
11	MW	1,240	1,185	1,135	940	900	945	1,050	1,055	930	905	970	1,235	
12	MW	1,225	1,155	1,110	925	890	955	1,070	1,075	945	895	955	1,195	
13	MW	1,215	1,145	1,100	925	890	955	1,085	1,085	940	890	945	1,185	
14	MW	1,225	1,150	1,110	925	880	960	1,090	1,090	940	895	955	1,195	
15	MW	1,225	1,140	1,115	920	855	935	1,070	1,070	900	900	960	1,205	
16	MW	1,230	1,130	1,110	905	830	910	1,045	1,045	880	915	980	1,235	
17	MW	1,285	1,155	1,120	905	825	910	1,040	1,040	855	985	1,060	1,315	
18	MW	1,385	1,265	1,190	930	845	920	1,050	1,050	870	1,115	1,200	1,415	
19	MW	1,405	1,350	1,295	985	870	935	1,065	1,075	885	1,145	1,205	1,445	
20	MW	1,390	1,345	1,325	1,050	900	940	1,065	1,080	995	1,090	1,175	1,430	
21	MW	1,350	1,320	1,305	1,090	960	985	1,090	1,095	1,020	1,045	1,095	1,375	
22	MW	1,240	1,210	1,195	1,020	920	980	1,075	1,085	920	925	990	1,265	
23	MW	1,065	1,060	1,035	895	815	880	970	975	825	805	865	1,125	
24	MW	865	860	840	745	690	745	835	835	710	655	710	915	
Σ	MWh	25,235	24,535	23,915	20,155	18,700	19,815	22,155	22,245	19,235	19,745	21,290	26,010	

Në total, pritet që konsumi bruto për vitin 2023 të jetë i rreth 8 TWh.

mënyra e mbulimit të kërkesës së pritshme është bërë në bazë të eksperiencës tashmë shumë vjecare, duke konsideruar prurjet në kaskadë me 75% siguri, nivelin e liqenit në Fierzë (të pritshëm) në fillim të vitit, rritjen potenciale të numrit dhe volumit të gjenerimit të PVE-ve dhe PPE-ve, eksportin e mundshëm nga ana e tyre në varësi të kushteve të tregut të brendshëm të energjisë dhe importit të energjisë që bëhet nga ana e FTL (OSHEE) dhe konsumatorëve të kualifikuar, duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit të tyre dhe kërkesën për energji, dhe duke treguar kujdes gjithashtu për optimizimin e kaskadës së Drinit, ruajtjen e kuotës në Fierzë, pra eficientë të gjenerimit, si dhe fillimin e vitit tjetër me një kuotë dhe rezervë energjetike optimale për të perballuar kërkesën për energji elektrike.

Parashikimi i parametrave kryesore dhe llogaritjet përkatëse janë të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Viti 2023	Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Prurja ne Fierze, me 75% siguri	m3/s	148	169	177	232	194.75	112	58	41	50	63	110	169	127
Prurja ne Fierze, faktike	m3/s	150	170	180	235	195	95	60	45	50	65	115	170	128
Kuota ne Fierze ne fillim te muajit	m	279.5	281.9	282.4	283.7	290.0	294.5	295.1	289.9	282.9	278.4	275.2	276.7	
Kuota ne Fierze ne fund te muajit	m	281.9	282.4	283.7	290.0	294.5	295.1	289.9	282.9	278.4	275.2	276.7	280.0	
Diferenca mesatare ditore	cm	7.6	1.8	4.2	21.0	14.5	2.0	-16.6	-22.6	-14.9	-10.6	5.0	10.6	0.2
Prodhimi ne Fierze	GWh	79.1	107.7	115.5	65.2	60.9	57.0	145.2	150.4	99.5	87.2	58.9	76.9	1,104
Prodhimi ne Koman	GWh	126.4	142.5	170.7	131.1	126.5	86.4	143.8	142.3	104.6	142.0	136.1	160.8	1,613
Prodhimi ne V.Dejes	GWh	66.3	74.0	89.4	71.5	67.6	46.6	72.3	71.5	53.7	72.3	70.9	84.6	841
Prodhimi ne Ashta	GWh	11.9	13.3	16.1	12.9	12.2	8.4	13.0	12.9	9.7	13.0	12.8	15.2	151
Prodhimi i Kaskades	GWh	283.8	337.5	391.7	280.6	267.2	198.5	374.3	377.1	267.4	314.5	278.7	337.6	3,709
Prodhimi ne HEC e Tjere	GWh	275.3	215.0	275.3	288.0	238.1	180.0	89.3	89.3	93.6	111.6	144.0	245.5	2,245
Prodhimi ne TEC	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Prodhimi i vendit	GWh	559	553	667.0	568.6	505.3	378.5	463.6	466.4	361.0	426.1	422.7	583.1	5,954
Konsumi i mujor	GWh	782.3	687.0	741.4	604.6	579.7	594.5	686.8	689.6	577.0	612.1	638.7	806.3	8,000
Konsumi mesatar ditor	GWh	25.2	24.5	23.9	20.2	18.7	19.8	22.2	22.2	19.2	19.7	21.3	26.0	21.9
Importi mujor	GWh	223	134	74	36	74	216	223	223	216	186	216	223	2,046
Importi mesatar ditor	GWh	7.2	4.8	2.4	1.2	2.4	7.2	7.2	7.2	7.2	6.0	7.2	7.2	5.6
Diferenca nga planifikimi mujor	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Diferenca nga planifikimi ditor	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Konsumi i planifikuar, mujor	GWh	782	687	741	605	580	594	687	690	577	612	639	806	8,000
Konsumi i planifikuar, ditor	GWh	25.2	24.5	23.9	20.2	18.7	19.8	22.2	22.2	19.2	19.7	21.3	26.0	21.9

Nga llogaritjet, me probabilitetin e pranuar të prurjeve në kaskadën e Drinit, (prurja mesatare vjetore në Fierzë 130 m3/s, në Koman 70 m3/s, në V.Dejes 20 m3/s), rezulton se prodhimi i pritshëm i kaskadës (pjesa e KESH) është i rendit 3.6 TWh, prodhimi i centraleve me koncesion dhe atyre private pritët të jetë rreth 2.4 TWh. Pjesa tjetër e energjisë e nevojshme për të mbuluar kërkesën për energji elektrike duhet të importohet, dhe pritët që fizikisht importi nga interkoneksioni të jetë i rendit 2 TWh.

Importi i energjisë nga OSHEE për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe nga Furnizuesit e Kualifikuar për konsumatorët respektivë, është kalkuluar në mënyrë komplementare me probabilitetin e përzgjedhur të prodhimit nga hidrocentralet e vendit. Ndryshimi i sasisë vjetore të importit që mund të diktohet nga ndryshimi i prodhimit të vendit si rrjedhojë e ndryshimeve të situatës hidrike, sic e ka treguar eksperiencia e deritanishme, nuk e ndryshon planifikimin e kërkesës për energji elektrike.

Bazuar në të dhënat historike, dhe duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të kërkesës së Konsumatorëve të Kualifikuar, prodhimin e PVE dhe PPE, si dhe sasinë e energjisë që nevojitet për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit, është plotësuar tabela e bilancit të energjisë për vitin 2023 si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2023
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	868	769	840	765	761	630	777	835	677	813	856	1,023	9,614
a)	Prodhim vendas	"	559	552	667	569	505	378	464	467	361	426	423	583	5,954
b)	Energji ne marrje	"	309	217	173	196	256	252	313	368	316	387	433	440	3,660
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	849	752	822	749	745	613	759	817	661	796	838	1,003	9,404
a)	Energji elektrike e dhene	"	86	82	99	160	181	36	90	145	100	201	217	217	1,614
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	688	605	648	494	464	482	569	567	461	500	526	711	6,715
c)	Energji elektrike per konsumatorët e kualifikuar	"	75	65	75	95	100	95	100	105	100	95	95	75	1,075
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit														
a)	Humbjet ne GWh	GWh	19	17	18	16	16	17	18	18	16	17	18	20	210
b)	Humbjet ne %	%	2.16%	2.21%	2.10%	2.14%	2.15%	2.63%	2.34%	2.21%	2.36%	2.08%	2.14%	1.93%	2.19%

Me të njëjtën mënyrë llogaritjeje, pra bazuar në të dhënat historike, është bërë parashikimi i bilancit energjetik për vitet në vazhdim, si në tabelat e mëposhtme:

Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2024
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	895	803	933	866	801	717	713	709	637	797	889	1,065	9,825
a)	Prodhim vendas	"	565	555	670	580	555	390	450	450	365	415	460	585	6,040
b)	Energji ne marrje	"	330	248	263	286	246	327	263	259	272	382	429	480	3,785
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	875	785	915	850	785	700	695	690	620	780	870	1,045	9,610
a)	Energji elektrike e dhene	"	105	120	220	230	220	125	15	5	55	170	240	235	1,740
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	675	580	600	530	470	485	590	595	480	510	520	685	6,720
c)	Energji elektrike per konsumatorët e kualifikuar	"	95	85	95	90	95	90	90	90	85	100	110	125	1,150
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit														
a)	Humbjet ne GWh	GWh	20	18	18	16	16	17	18	19	17	17	19	20	215
b)	Humbjet ne %	%	2.23%	2.24%	1.93%	1.85%	2.00%	2.37%	2.52%	2.68%	2.67%	2.13%	2.14%	1.88%	2.19%
Nr.	Emertimi	Njesia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2025
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	906	863	948	816	786	763	834	810	677	752	839	941	9,935
a)	Prodhim vendas	"	580	560	675	595	570	400	490	490	365	405	435	560	6,125
b)	Energji ne marrje	"	326	303	273	221	216	363	344	320	312	347	404	381	3,810
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	885	845	930	800	770	745	815	790	660	735	820	920	9,715
a)	Energji elektrike e dhene	"	110	175	225	170	205	165	125	85	90	130	185	105	1,770
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	675	575	600	535	475	485	590	600	480	510	520	685	6,730
c)	Energji elektrike per konsumatorët e kualifikuar	"	100	95	105	95	90	95	100	105	90	95	115	130	1,215
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit														
a)	Humbjet ne GWh	GWh	21	18	18	16	16	18	19	20	17	17	19	21	220
b)	Humbjet ne %	%	2.32%	2.09%	1.90%	1.96%	2.04%	2.36%	2.28%	2.47%	2.51%	2.26%	2.26%	2.23%	2.21%

Tabela e mëposhtme pasqyron parashikimet e Bilancit të energjisë për vitet 2023-2025

	Njesia	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Prodhimi Vendas TOTAL	GWh	8,077	4,767	4,892	8,432	5,616	5,954	6,040	6,125
Energji ne Marrje	GWh	1,772	3,177	3,239	2,253	3,829	3,660	3,785	3,810
ENERGJI TOTALE NË SISTEMIN E OST	GWh	9,848	7,943	8,131	10,685	9,445	9,614	9,825	9,935
Transmetuar OSHEE	"	5,963	6,137	6,184	6,606	6,696	6,715	6,720	6,730
Transmetuar KK	"	957	867	811	1,050	990	1,075	1,150	1,215
Konsumi		6,921	7,004	6,995	7,656	7,686	7,790	7,870	7,945
Energji ne dhenie	GWh	2,685	770	963	2,800	1,553	1,614	1,740	1,770
ENERGJI TRANSMETUAR NGA OST	GWh	9,606	7,775	7,958	10,457	9,239	9,404	9,610	9,715
Humbjet ne rrjet	GWh	243	169	173	228	207	210	215	220
Humbjet ne rrjet	%	2.46%	2.13%	2.13%	2.13%	2.19%	2.19%	2.19%	2.21%

VI. Llogaritja e tarifave të transmetimit për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025

Në përputhje me metodologjinë, OST sh.a. ka bërë përlllogaritjet për të ardhurat e kërkuara dhe kostot totale të cilat ajo do të perballojë gjatë gjithë vitit 2023 dhe periudhës 2023-2025.

Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohen nga OST do të mbulojë të gjitha kostot e lejuara nga Metodologjia e Transmetimit të Energjisë Elektrike respektivisht kostot e kapitalit dhe kostot operative.

Në mënyrë të përmbledhur, mënyra e përlllogaritjes së tarifës mesatare të transmetimit paraqitet si vijon:

$P_{mesatare}$ Tarifa mesatare e Transmetimit, sipas formulës:

$$P_{mesatare} = \frac{C}{E}$$

C Kërkesa për të ardhura;

E Energjia totale në kWh që do të tregtohet në faturat e konsumatorit;

C Kërkesa për të ardhura, sipas formulës:

$$C = C_{kapitale} + C_{operuese}$$

$C_{kapitale}$ Kostot e kapitalit (investimet + kosto e borxhit);

$C_{operuese}$ Kostot Operative;

$C_{kapitale}$ Kostot e kapitalit (investimet + kosto e borxhit), sipas formulës:

$$C_{kapitale} = R + D$$

R Kthimi mbi bazën e rregulluar te aseteteve;

D Amortizimi i aseteteve;

R Kthimi mbi bazën e rregulluar te aseteteve, sipas formulës:

$$R = B \times WACC$$

B Baza e rregulluar e Aseteteve;

$WACC$ Norma e lejuar e kthimit të Asetetit të rregulluar, sipas formulës:

$$WACC = \left[ES \times \frac{ARoE}{1 - T} \right] + (DS \times CoD)$$

Në mënyrë më të detajuar, analiza e këtyre elementeve të tarifës, pasqyrohet si më poshtë vijon:

A. Kostot kapitale

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në perputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi është një nga funksionet themelore të OST dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj.

Gjatë viteve të fundit janë kryer një seri studimesh të sistemit të transmetimit që kanë përcaktuar projektet kryesore të nevojshme për zhvillimin e tij. Disa nga këto projekte janë në fazë implementimi dhe për të tjerat, për të cilët është siguruar financimi nga institucione financiare ndërkombëtare do të vihen në zbatim në një periudhë kohore të përcaktuar.


Programi i investimeve të OST për vitet 2023 - 2025 është fokusuar kryesisht në:

- Rehabilitimin e rrjetit të transmetimit nëpërmjet rikonstruksionit të linjave ekzistuese me normë të lartë amortizimi dhe me rëndësi për sigurinë e sistemit;
- Ndërtimin e linjave të reja unazore duke rritur sigurinë e furnizimit nëpërmjet plotësimit të kushtit të sigurisë statike;
- Rritjen e kapaciteteve akomoduese të rrjetit në funksion të mbështetjes së politikës së diversifikimit të burimeve të energjisë elektrike dhe lidhjen e centraleve të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE);
- Rehabilitimit dhe ndërtimit të linjave të reja të interkonjeksionit duke bërë të mundur rritjen e shkëmbimeve ndërkufitare, sigurinë dhe besueshmërinë e operimit të rrjetit si dhe të cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

VII. Parshikimi i Investimeve për vitin 2023 dhe periudhën 2023-2025

Gjatë viteve 2023-2025, OST sh.a., parashikon të kryejë rreth 17 miliardë lekë investime, nga të cilat, rreth 44 % të financuara me fonde të huaja, ndërsa pjesa tjetër parashikohet të bëhet me fondet e OST sh.a..

Investimet 2023-2025 (Mln. Lekë)



Në mënyrë të përmblodhur, programi i investimeve për këtë periudhë paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Sipas burimeve të financimit	Njesia	2023	2024	2025	2023-2025
Burimet e veta	Mln. Lekë	3,207	3,206	3,152	9,566
Ndihmë dhe kredi e huaj	Mln. Lekë	3,289	4,161	0	7,450
Totali i Investimeve	Mln. Lekë	6,496	7,368	3,152	17,016

VII.1 Projektet e Investimeve me fonde të huaja

PROJEKTI “PROGRAMI I EFIÇENCËS SË ENERGJISË TË SEKTORIT TË TRANSMETIMIT” -LOTI 1- NËNSTACIONET DHE LOT 2- LINJAT

FINANCIMI: Ky projekt financohet nga një kredi prej 40,000,000.00 Euro e akorduar nga Qeveria Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW.

PËRFITIMET: Ky projekt do të bëjë të mundur rritjen e besueshmërisë së funksionimit të rrjetit 220 kV të rajonit të Durrësit dhe të Jugut të Shqipërisë duke plotësuar kriteret teknike të sigurisë dhe cilësisë. Gjithashtu ky projekt do të përmirësojnë kushtet aktuale të furnizimit me energji elektrike të qytetit të Tiranës, duke konsideruar që një pjesë e rëndësishme e rrjetit unazor 110 kV që furnizon me energji elektrike nënstacionet e sistemit të shpërndarjes në zonën e Tiranës, i ndërtuar përpara mbi 40 vjetësh i përbërë nga linja ajrore të amortizuara dhe kapacitet transmetimi të limituar.

NDËRTIMI I LINJËS SË INTERKONJEKSIONIT 400 KV ELBASAN2 (SHQIPËRI) – BITOLA (MAQEDONI) DHE ELBASAN2 – FIER SI DHE SI DHE ZGJERIMI I NËNSTACIONEVE ELBASAN2 DHE FIER

FINANCIMI: Financimi i këtij projekti, do të sigurohet nga Bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar i Zhvillimit. Tashmë janë angazhuar fondet për një kredi të zhvillimit deri në 50.000.000 Euro për Qeverinë Shqiptare. Përveç kësaj, për të mbuluar financimin e plotë të projektit, do të vihet në dispozicion një grant nga WBIF prej 13.720.000 Euro. Gjithashtu, rreth 1.131.000 Euro, do të angazhohen nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano-Shqiptar, fonde të cilat do të përdoren për përgatitjen e dizajnit kryesor. OST sh.a., është angazhuar të mbulojë gjatë implementimit të projektit dhe kostot lokale, të cilat janë përlllogaritur të jenë rreth 5 milion Euro.

PËRFITIMET: Ky projekt përforcon lidhjet interkonektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike, dhe si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian.

VII.2 Projektet e Investimeve me fonde të OST

ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË TRANSMETIMIT NË ZONËN FIER-VLORË DHE NDËRTIMI I NËNSTACIONIT HOXHARË

Nevoja për zhvillimin e rrjetit

Zhvillimi i sistemit të transmetimit është një domosdoshmëri e cila shërben për të garantuar furnizimin pa ndërprerje dhe me cilësi për të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit.

Sikurse dihet, përdoruesit e rrjetit të transmetimit ndahen në dy grupe (kategori), në konsumatorë dhe prodhues të energjisë elektrike. Vitet e fundit kategoria e dytë, ajo e prodhuesve, ka pasur një zhvillim të madh dhe kryesisht kanë qenë të karakterit hidro. Në përgjithësi, ata janë shtrirë në të gjithë teritorin e vendit të lidhur në nivele të ndryshme tensioni. Futja në operim e këtyre gjeneruesve ka përmirësuar situatën lidhur me prodhimin vendas të energjisë elektrike, ky prodhim është thuhetse 100% hidro. Karakteri i theksuar hidro i prodhimit vendas, ka sjellë për pasojë një varesi të madhe të plotësisht të nevojave për energji elektrike të vendit nga viti “hidrik” dhe vështirësi në menaxhimin e rezervave hidrike në kaskadën e Drinit.

Është e qartë dhe pa asnjë dyshim nevoja për ndërtimin e burimeve alternative me synim diversifikimin e prodhimit të energjisë elektrike në vend. Në këtë kuadër janë planifikuar dhe në fazë ndërtimi disa impiante foto-voltaike kryesisht në jug të vendit.

Duke bërë një vlerësim të kërkesave dhe të lejeve të dhëna deri më sot për ndërtimin e këtyre impianteve (disa qindra MW kapacitet i instaluar) është e nevojshme që të planifikohet zhvillimi i infrastrukturës së rrjetit të transmetimit për të bërë të mundur absorbimin nga rrjeti të kësaj sasive energjie që do të prodhohet nga këto impiante foto-voltaike.

Në këtë kontekst, vlen që të përmendet fakti se nga kompania e shpërndarjes OSSH, në zonën e Hoxharës është në fazën e ndërtimit një nënstacion i ri 110/35/20 kV, i cili do të shërbejë për lidhjen e disa prej këtyre prodhuesve të energjisë elektrike nga impiantet foto-voltaike.

2-Ndërtimi i nënstacionit 400/220/110 kV Hoxharë

Aktualisht rrjeti i transmetimit në jug dominohet nga niveli 110 kV i cili me investimet e bëra në dhjetëvjeçarin e fundit është fuqizuar ndjeshëm dhe është lidhur në unazë me rajonin Jug-lindor të vendit.

Skema egzistuese e sistemit të transmetimit në jug është si në Fig 1, ku duket qartë që dy linjat kryesore që furnizojnë këtë rajon, janë linjat 220 kV Elbasan –Fier (220-07) dhe linja Rrashbull-Fier (220-15/3).

Vëmë në dukje se linja 220 kV Fier –Babice (220-17) aktualisht është në operim me një qark, por është e projektuar për dy qarqe 220 kV (mungojnë percjellesit e njërit qark dhe dy traktet 220 kV respektivisht në Fier dhe Babicë).

Nisur nga sa thamë më sipër, për të fuqizuar rrjetin e transmetimit në këtë rajon që të bëhet e mundur absorbimi i energjisë që do të prodhohet nga impiantet foto-voltaike propozojmë ndërtimin e një nënstacioni të ri në zonën e Hoxharës i cili të jetë 400/220/110 kV.

Ndërtimi i këtij nënstacioni të bëhet me dy faza zhvillimi.




Figura 1

Në fazën e parë të zhvillohet në nivelin 220/110 kV i cili do të lidhet me rrjetin e transmetimit nëpërmjet “çarjes së linjës Fier –Babicë (220-17) dhe nga ana 110 kV me nënstacionin e ri të OSSH nëpërmjet zgjatimit të zbarave të këtij nënstacioni.

Në këtë fazë mund të përdoren autotransformatorët 100 MVA 220/110/20 kV të cilët do të dalin të lirë nga projekti për fuqizimin e N/st Rrashbull (projekt që është në implementim e sipër), skema do të jetë si në Figuren 2.

Po ashtu në këtë fazë duhet të parashikohet edhe shtrimi i përcjellësit në qarkun e dytë në linjën 220 kV Fier –Babicë e cila do të plotësohet me trakte në momentin që do të jetë “konturuar” projekti për zgjerimin e N/st Fier .

Në prespektivë me zhvillimin e rrjetit 400 kV, shikohet mundësia që të bëhet edhe unaza 400kV Fier – Hoxharë – Rrashbull dhe instalimi i transformatoreve 400/110 kV e cila do të jetë e aftë të rrisë shumë kapacitetin e transmetimit në këtë rajon dhe do të jete zgjidhje përfundimtare.

Gjithashtu, për shkak të upgradeve të pritshme të TEC Vlorë, duke marrë parasysh që pas vënies në punë të gjeneruesve lundruar diesel nuk do të jetë me e mundshme stakimi i linjës 220kV BABICE – TEC Vlorë dhe TEC-i Vlorë do ti nënshtrohet një rehabilitimi me rritje kapacitetit të prodhimit është e nevojshme që qarku i dytë i linjës TEC Vlorë të instalohet gjatë vitit 2022 pasi në vitet e ardhshme do të jetë e pa-mundur stakimi i kësaj linje.




Figura 2

Theksojmë që sipërfaqja që do të vihet në dispozicion të këtij nenstacioni duhet të ketë marrë në konsideratë instalimin :

- 1- Dopoljo zbare për anën 400 kV
- 2- Dopoljo zbare për anën 220 kV
- 3- Dopoljo zbare për anën 110 kV
- 4- Tre trakte linje 400 kV
- 5- Katër trakte linje 220 kV
- 6- Katër trakte linje 110 kV
- 7- Instalimin e dy autoveve 220/110
- 8- Instalimin e dy transformatorëve 400/110 kV

Theksojmë që nga dinamikat e zhvillimit (ndertimi të ketyre impianteve foto-voltaike) do të jetë edhe ecuria e implementimit të këtij projekti për ndertimin e n/st Hoxharë dhe linjave që do të lidhin këtë nenstacion me rrjetin e transmetimit.




ZGJERIMI N/ST TIRANA1 TR 220/20 63 MVA (TRAKTI 220 KV, SEKSIONI TRETË 20 KV DHE BAZAMENTI TR 63MVA)

Nënstacioni Tirana1, i ndërtuar në vitin 1972 është rikonstruktuar plotësisht në vitin 2011. Ai është i pajisur me tre autotransformatorë 220/110/35 kV me fuqi të instaluar 120 MVA secili si dhe dy transformatorë 220/20 kV me fuqi të instaluar 63 MVA secili, ana 20kV e të cilëve mbulon një pjesë të rëndësishme të rrjetit të shpërndarjes së qytetit të Tiranës. Zhvillimi i ngarkesës së transformatorëve të fuqisë 220/20 kV të nënstationit elektrik Tirana-1, është e lidhur ngushtë me planin zhvillimor të ngarkesës dhe të rrjetit 20kV të qytetit të Tiranës.

Aktualisht, nga analiza e bërë mbi bazën e ngarkesave maksimale të realizuara në vitet 2017-2018-2019, rezulton se dalja nga operimi i njërit prej transformatorëve 220/20 kV në nënstationin Tirana1, mbingarkon transformatorin tjetër deri në 166% për vitin 2019, pra nuk kemi plotësim të kriterit të sigurisë N-1 për këta transformatorë.

Nga analiza e të dhënave të siguruar dhe nga llogaritjet e bëra për këtë qëllim, del se instalimi i një transformatori të ri 220/20kV me fuqi 63 MVA, do ti shërbëjë rritjes së sigurisë së furnizimit dhe operimit duke shërbyer si rezervë sigurie në rast të daljes eventuale jashtë pune të njërit prej transformatorëve ekzistues.



Transformatori i ri shtesë 220/20kV, 63MVA në Tirana1.

PËRFITIMET:


- Rritjen e sigurisë së furnizimit dhe operimit duke shërbyer si rezervë sigurie në rast të daljes eventuale jashtë pune të njërit prej transformatorëve ekzistues.
- Rritjen e sigurisë së furnizimit në tërësi të rrjetit unazor 20kV të shpërndarjes të Rajonit të Tiranës për shkak se fiderat dalës 20kV nga nënstationi Tirana1 janë në lidhje unazore me fiderat dalës nga n/stacionet 110kV të Traktorave, Selitë dhe Qendër.

ZGJERIMI DHE RIKONSTRUKSIONI N/ST SHARRË

Nënstacioni Sharrë aktualisht ka të instaluar dy autotransformatorë fuqie AT-1 220/110 kV 100MVA dhe AT-2 220/110/35 kV 90 MVA. Ky nënstacion furnizohet nga linjat 220 kV Tirana2-Sharrë dhe Elbasan2-Sharrë . Nga zbarat 110 kV të këtij nënstacioni dalin dy linja 110 kV, Linja Sharrë –Selitë dhe linja Sharrë Rrashbull. Nga ky nënstacion del dhe linja 35 kV Sharrë –N/st Selitë (nënstacion i OSHEE).

Ashtu sikundër edhe shikohet nga diagrama e mëposhtme, skema e këtij nënstacioni ka disa të meta dhe mangësi themelore dhe konkretisht:

- Mungojnë traktet 220 kV për të dy linjat 220 kV
- Mungesa në elementet e traktit 110 kV të AT (mungon çelësi 110 kV dhe thika 110 kV)
- Mungesë e shkarkuesve në traktet e linjave 110 kV
- Ka vetëm një seksion nga ana 220 kV
- Ka vetëm një seksion nga ana 110 kV
- Lidhja e të dy autotransformatorëve “kokë më kokë” nga ana 220 kV .



Skema aktuale njëpolare e nënstacionit Sharrë

Duke marrë në konsideratë projektet për zhvillimin e rrjetit që janë në fazën e implementimit në rajonin e Tiranës si:

- Zhvillimi i “unazës” të Tiranës, ndërtimin i nënstacionit Tirana 3. Në këtë projekt veç të tjerave është planifikuar edhe ndërtimi i linjës së re 110 kV Tirana3-Selitë (linjë kjo që do të zëvendësojë linjën ekzistuese 110 kV Selitë – Traktora e cila do të demontohet). Ndërtimi i kësaj linje 110 kV pritet të ulë ngarkesën nga ana 110 kV në nënstacion Sharrë.
- Implementimi i projektit për ndërtimin e linjës dyfishe 220 kV Tirana2-Rrashbull do përmirësojë në mënyrë të ndjeshme sigurinë e furnizimit në rajonin e Durrësit, dhe ul ngarkesën e anës 110 kV të nënstacionit Sharrë.
- Ndërtimi dhe vënia në operim e nënstacionit 110/20 kV Kombinat (investim i OSHEE) do të përmirësojë furnizimin e rajonit në këtë zonë dhe pritet të ulë ngarkesën e anës 35 kV të nënstacionit Sharrë.

Pritet që pas përfundimit të këtyre investimeve ngarkesa e nënstacionit Sharrë të reduktohet por gjithsesi roli i këtij nënstacioni nga pikpamja e rezervimit të ngarkesës dhe e sigurisë së furnizimit të konsumatorëve (Rajoni Tiranë-Durrës) do të vazhdojë të jetë i rëndësishëm si për rastet e remonteve ashtu edhe për rastet e difekteve .

Një aspekt tjetër që duhet vënë në dukje është se veç mangësive që ky nënstacion ka në skemën primare me e rëndësishmja është që të dy autotransformatorët e instaluar në këtë nënstacion janë tejet të amortizuar (mbi 50 vjet në operim).


Për sa më sipër propozojmë që ky nënstacion të rikonstruktohet, skema e këtij nënstacioni të zhvillohet , të plotësohet me elementet e nevojshëm dhe të vendosen autotransformatorët të cilët do të demontohen në nënstacion Rrashbull 2 x 220/110/20 kV 100MVA.

Fuqizimi, zhvillimi i këtij nënstacioni sipas standartit që tashmë është në OST (nënstacion me dy pale zbara nga ana 220 dhe 110 kV) është i veshtirë për shkak të hapësirave të limituara. Për këtë arsye është analizuar si mundësi zhvillimi i tij me dy seksione 220 kV dhe me dy seksione 110 kV. Detyruar nga hapësirat e kufizuara dhe pamundësinë e zgjerimit të territorit të nënstacionit realizimi i zhvillimit të skemës është i mundur vetëm nëse përdorim paisje hibride, paisje HGIS. Këto paisje janë të integruara dhe japin mundësinë e plotësimit të skemës me elementet e nevojshëm në një sipërfaqe shumë të reduktuar krahasuar me paisjet klasike .

Skema që propozohet për zhvillimin e këtij nënstacioni është skema tip “H” duke përdorur trakte për linjat 220 kV , trakte për transformatorët nga ana 220 kV dhe 110 kV , trakt seksionimi nga ana 220 kV dhe trakt (ose thikë seksionimi) seksionimi nga ana 110 kV .

Zëvendësimi i autotransformatorit ekzistues 220/110 kV 100 MVA me autotransformatorët që demontohen në N/stacionin 220/110 kV Rrashbull është i domosdoshëm për shkak të kohës së gjatë të operimit (mbi 50 vjetet).

Realizimi i këtij investimi rrit sigurinë e furnizimit të nënstacionit 110 kV Selitë dhe nënstacionit 220/110 kV Rrashbull, rrit fleksibilitetin e skemës dhe krijon mundësinë pa krijuar shtrengesa për nxjerrjen në skemë remonti të elementëve të rrjetit në këto rajone .



Skema e zhvilluar njëpolare e nënstacionit Sharrë

Përmirëson cilësinë e furnizimit duke përmirësuar profilin e tensioneve (autotransformatorët që do të vendosen në Sharrë janë me rregullator automatik të tensionit në ngarkesë) dhe në mënyrë të veçantë nga pikëpamja e sigurisë së furnizimit, rezervon furnizimin e nënstacioneve në nivein 110 kV.

Për realizimin e punimeve për zhvillimin , rikonstruksionin e nënstacionit Sharrë minimalisht do të punohet me dy faze, ku faza e parë konsiston në:

✓ *Faza e parë*


Për të mos çenuar operimin e nënstacionit në fazën e parë rekomandohet të zhvillohet pjesa e pa shfrytëzuar, pra ndërtimi i traktit të linjës 220-13/3, zbarat e seksionit të dytë 220 kV si dhe traktin nga ana 220 kV të autotransformatorit 220/110/20 kV që do të shtohet (përfshirë punimet për bazamentin e AT) po ashtu mund të punohet për traktin e anës 110 kV të kësaj AT deri në lidhjen me seksionin ekzistues 110 kV.

Për të bërë të mundur punimet e kësaj faze duhet të modifikohet skema e furnizimit të këtij nënstacioni duke e kthyer siç ka qenë para ndërhyrjes, të lidhet në formë “T” në linjën 220 - 13/2 Tirana2-Elbasan2, duke lënë jashtë pune daljen e linjës 220/13/3 në drejtim të Elbasan 2 (të mbyllet harqet tek shtylla ankerore ku është bërë çarja e linjës) .

Duke qenë se do të punohet në pjesën e lirë të teritorit nevoja për stakime do të jetë minimale (me interval ditor) gjatë procesit fillestar të modifikimit të skemës dhe në fund të fazës së parë për të bërë lidhjet dhe vënien në tension si nga ana 220 dhe 110 kV. Përfundimi i kësaj faze krijon kushtet për të vijuar me fazën e dytë .

ZGJERIMI I NST F.KRUJE ME NJE AUTO 220/110KV DHE TRAKT TE RI 220KV NGA FABRIKA CIMENTOS

Nënstacioni 110 /6 kV F.Krujë është një nënstacion i ndërtuar rreth viteve 1970. Në këtë nënstacion terminojnë tre linja 110 kV, linja Tirana1-F.Krujë, Laç2- F.Krujë dhe linja 110 kV F.Krujë – Krujë (linje radiale). Ka të instaluar dy transformator fuqie 110/6 kV të cilët aktualisht janë 31.5 MVA dhe tjetri po 110/6 kV me fuqi 10 MVA . Ky nënstacion është i pozicionuar në veri të qytetit të F.Krujes në një zonë industriale pranë fabrikës së çimentos ku ambienti është i ngarkuar me pluhur. Skema njëpolare e këtij nënstacioni është si në figurën në vijim;




Skema njëpolare e nënstacionit 110/6kV te Fushë Krujës

Nga skema shihet se dy linjat 110 kV në drejtim të Tirana1 dhe të Laç 2 janë me thika ndërsa linja në drejtim të Krujës është me trakt të rregullt (kryer para 10 vjetësh). Theksojmë se gjëndja e paisjeve primare është tejet e amortizuar, sikurse thamë edhe për shkak të kohës së gjatë të operimit dhe për shkak të ambientit të ndotur .


Prej shume vitesh çelsi seksionues është jashtë funksioni (i shuntuar), edhe elementet e tjerë dhe paisjet komutuese janë tejet të amortizuara .

Sa i përket ngarkesës që ka si nënstacion vlen të theksohet se ka pasur një reduktim vitin e fundit pas ndërhyrjes së OSHEE e cila ka instaluar një nënstacion portabel i cili është lidhur në forme “T” në linjën 110 kV Tirana1-F.Krujë dhe ka të instaluar një transformator 110/20 kV me fuqi 25 MVA. Megjithatë ngarkesa e nënstacionit F.Krujë vijon të jetë relativisht e madhe .

Ngarkesat e këtij nënstacioni gjatë vitit 2019, janë pasqyruar në grafikun e mëposhtëm të ndarë sipas muajve (energji e konsumuar grafiku 1 dhe ngarkesa maksimale grafiku 2). Në këta grafike janë pasqyruar dy transformatorët e nënstacionit F.Kruje si dhe ngarkesa e nënstacionit Kruje i cili furnizohet radialisht nga zbarat 110 kV të nënstacionit F.Kruje.



Grafiku 1 :Energjia e konsumuar nga ana 110 kV (F.Kruje+Kruje)




Grafiku 2 :Piku ngarkeses nga ana 110 kV (F.Kruje+Kruje)

Për shkak të ngarkesave të konsiderueshme të këtij nënstacioni, OST në vitin 2013 për të rritur kapacitetin e transmetimit të linjes 110 kV Tirana1-F.Krujë, investoi në ndërrimin total të percjellesit të kësaj linje duke rritur seksionin e tij nga Al/Ç 120 mm² ne Al/Ç 150 mm²

Nga ana tjetër, nënstacioni 110 kV F.Kruje praktikisht furnizohet nga zbara 110 kV e nënstacionit 220/110/35/20 kV Tirana 1. Nënstacioni Tirana 1 nga ana 110 kV (zbarën 110 kV) furnizohet me tre autotransformator 220/110/35 kV me fuqi 120 MVA. Ngarkesa e nënstacionit Tirana 1 nga ana 110 kV ne muajt e dimrit dhe veçanerisht në orët e pikut në këtë sezon është relativisht shumë e madhe dhe nga pikpamja e fuqisë transformuese është e pa rrezervuar .


Ngarkesat e autotransformatoreve në nënstacionit 220/110/35/20 kV Tirana1 gjatë vitit 2019 janë pasqyruar në grafiket e mëposhtëm të ndarë sipas muajve (energji e konsumuar grafiku 3 dhe ngarkesa maksimale ne tre autotransformatorët 220/110/35 kV e matur nga ana 220 kV grafiku 4)

Energjia Mujore per
2019 (MWh)



Grafiku 3 :Energjia e konsumuar nga ana 220 kV (AT1,AT2,AT3 ne Tirana1)

Ngarkesa maksimale , (piku) per 2019 (MW)



Grafiku 4 : Piku i ngarkesës nga ana 220 kV (AT1,AT2,AT3 ne Tirana1)

Nëse gjatë sezonit me ngarkesa të mëdha (sezonit të dimrit) do të dilte nga operimi njëri nga autotransformatorët 220/110/35 kV ashtu siç duket edhe nga grafiku i mësipërm, kjo do të kërkonte reduktim të ngarkesës së këtij nënstacioni (kufizime relativisht të mëdha të rendit ~ 40 MW).

Duhet patur parasysh që ngarkesa e zbares 110 kV e nënstacionit Tirana 1 është shumë e vështirë të reduktohet pasi konsumatorët që furnizohen nga kjo zbare, përjashtojnë nënstacionin F.Kruje, kryesisht janë qyteti i Tiranës dhe institucionet e rëndësishme të shtetit.

Zhvillimi i skemës në nënstacionin 110 /6 kV F.Kruje

Duke u nisur nga sa thamë më sipër, propozojmë që skema e nënstacionit 110/6 kV F.Krujë të zhvillohet, të zgjerohet duke u lidhur në nivelin 220 kV nëpërmjet një autotransformatori 220/110/20 kV .

Ajo çfarë në thelb përfshin zhvillimi i Nënstacionit 110/6 kV F.Kruje konsiston në instalimin e një autotransformatori me fuqi 90-120 MVA 220/110/20 kV.

Ky autotransformator nga ana 220 kV do të furnizohet nëpërmjet linjës së re e cila duhet të ndërtohet nga nënstacioni 220/6kV Fabrikes Çimentos F.Kruje deri tek Nënstacioni 110 /6 kV F.Kruje. Nga ana 110 kV do të lidhet me zbarat egzistuese të Nënstacionit 110/6 kV F.Kruje.

Sigurisht për shkak të amortizimit të madh të pajisjeve është e nevojshme të bëhet edhe rikonstruksioni i zbarave 110 kV të këtij nënstacioni përfshi dhe ndërtimin e dy trakteve të reja 110 kV për linjat F.Kruje –Laç1 dhe F.Kruje –Tirana1.

Nënstacioni 220/6kV Fabrikes Çimentos F.Kruje fizikisht është i pozicionuar në një distance ~250 ml nga Nënstacioni 110 /6 kV F.Kruje. Ndërtimi i linjës së re 220 kV përfshin edhe ndërtimin e traktit 220 kV në nënstacionin 220/6 kV Fabrikes Çimentos.

Sa i përket zhvillimit të anës 220 kV në Nënstacion 110/6 kV F.Kruje, duke qenë se hapësirat e nënstacionit janë të kufizuara, propozojmë që të ndërtohet vetëm trakti i autotransformatorit nga ana 220 kV (pa trakt linje 220 kV), edhe për faktin se distanca (gjatësia e linjës 220 kV) është e vogël ~250 ml.

Linja e re 220 kV F.Çimento – F.Kruje mund të konsiderohet si “zgjatim” i zbarave 220 kV të nënstacionit 220/6 kV F.Çimento dhe në këtë sens nuk është i domosdoshëm ndërtimi i traktit 220 kV të kësaj linje në nënstacion F.Kruje .

Nga ana 110 kV do të ndërtohet një seksion i ri në zgjatim dhe në aks të seksioneve egzistuese ku do të lidhet nga ana 110 kV me trakt të rregullt autotransformatori 90 MVA 220/110/20 kV.

Seksioni i ri 110 kV do të lidhet me seksionin egzistues vetëm nëpërmjet një ndarësi (thike) 110 kV. Po ashtu, do të ketë edhe daljen 20 kV e cila mund të zhvillohet në të ardhmen me ndërtimin e impiantit 20 kV sipas kërkeses dhe nevojës së kompanisë së shpërndarjes OSSH.

Skema e nënstacionit F.Kruje pas ndërhyrjes për zhvillimin dhe rikonstruksionin e tij do të jetë si në Figuren 2 në vijim:




Fig3 . Unazimi i nenstacionit F.Kruje me rrjetin 220 kV

Lidhur me implementimin e këtij projekti, si për zhvillimin e skemës ashtu edhe rikonstruksionit të trakteve 110 kV, nuk parashikohet ndonjë problem sa i përket operimit të nënstacionit 110/6 kV F.Kruje. Pjesa që do të zhvillohet është planifikuar të ndërtohet në një shesh të lirë që egziston brenda rrethimit të nënstacionit, ndërsa rikonstruksioni i trakteve 110 kV do të realizohet si në të gjithë nënstacionet e tjerë, trakt pas trakti duke shmangur ndërprerjet për intervale të gjata të furnizimit me energji të konsumatoreve që furnizohen nga ky nënstacion.

Në nënstacionin 220/6 kV F.Çimento, egziston vendi për ndërtimin e daljes së linjës së re 220 kV F.Çimento- F.Kruje.

Në foton në vijim tregohet një pamje nga lart e nënstacionit F.Kruje 110 kV dhe nënstacionit 220 /6 kV F.Çimento dhe gjurmës së linjës së re që duhet ndërtuar .



Pamja e nënstacionit F.Kruje dhe F.Çimento

Zërat kryesorë të punimeve që parashikohen të kryhen për realizimin e këtij projekti (furnizim-vendosje), të ndarë sipas fazave:

Punime për fazën e parë

- 1- Ndërtimi i traktit 220 kV në nënstacion F.Çimento
- 2- Ndërtimi i linjës së re 220 kV F.Çimento-F.Kruje (gjatesia ~250 ml)
- 3- Ndërtimi i bazamentit të Autotransformatorit
- 4- Blerja dhe instalimi i një autotransformatori 90-120 MVA
- 5- Ndërtimi i traktit 110 kV i autotransformatorit në N/st F.Kruje

Punime për nje fazë të dytë

- 1- Rikonstruksioni i tre trakteve dhe zbarave 110 kV të N/st F.Kruje
- 2- Punime për rikonstruksionin e godinës

Disa nga avantazhet kryesore që sjell ky investim janë:

- Përmirëson cilësinë e furnizimit duke siguruar rezervim për konsumatorët e rajonit të F. Krujës, Krujes, Laçit dhe konsumatorëve që furnizohen nga zbara 110 kV e nënstacionit Tirana1. Rezervon furnizimin e Fabrikës së Çimentos.
- Vendosja e një autotransformatori (nëpërmjet RAT) do të bëjë të mundur dhe rregullimin e profilit të tensioneve në rrjetin 110 kV të këtij rajoni .
- Nëpërmjet rikonstruksionit të trakteve dhe zbarave 110 kV do të rritet siguria e furnizimit të konsumatorëve që furnizohen nga N/st F.Krujë.
- Rritet shumë “fleksibiliteti” i skemës nga ana 110 kV.

Krijon mundësinë për zhvillimin në prespektivë të rrjetit 20 kV në rajonin e F.Krujës.

RIKONSTRUKSIONI I N/ST. GOLEM DHE TRAKTI 110KV N/ST. KOMBINAT

Gjëndja në të cilën ndodhet aktualisht impianti 110 kV, në Nënstacionin 110/20/6 kV Golem është radiale dhe nuk garanton furnizim të sigurt me energji elektrike për zonën turistike të plazhit të Durrësit. Ky N/st është i lidhur në formë “T” dhe si i tille nuk garanton sigurinë e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve që janë të lidhur.

Për vetë rëndësinë në garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, është e domosdoshme ndërhyrja në rehabilitimin e këtij impianti 110 kV si dhe skema e furnizimit nga linja L 110-61/2 të bëhet hyrje-dalje në N/St Golem.

Pas rehabilitimit, me zhvillimin dhe rikonstruksionin e anës 110 kV, duke ndërtuar dy trakte 110 kV do të bëhet hyrje-dalje sipas standardit (ploteson kriterin N-1), duke bërë të mundur rezervimin e furnizimit të këtij nënstacioni.

Gjithashtu, një problematikë tjetër e shfaqur në Rajonin e Tiranës është edhe situata me Linjën dyfishe 110 kV L.110-46/47 Tirana2-Selitë, linjë e cila ka ngelur e pa shfrytëzuar në njërin qark të saj pas ndërtimit të Nënstacionit Qelq në Kombinat. Në mënyrë që të rritet siguria e furnizimit të Nënstacioneve Qelq dhe Selitë, është e nevojshme që të kryhet ndërtimi i një trakti të plotë Linje pranë Nënstacionit Qelq në mënyrë që Linja dyfishe L.110-46/47 të kthehet në operativitet të plotë dhe të rrisë në mënyrë të ndjeshme sigurinë e furnizimit të këtyre nënstacioneve

RIKONSTRUKSIONI I SHTYLLAVE METALIKE TË LINJAVE TË TENSIONIT TË LARTË 220KV DHE 400KV

Për mirmbajtjen e linjave të transmetimit, të cilat në shumë raste janë të vjetra dhe me probleme të koordinimit të strukturave metalike, për rritjen e jetgjatësisë së tyre dhe qëndrueshmërisë ndaj korrozionit mbështetur edhe në rregulloren e shfrytëzimit, nga ana e OST sh.a., konsiderohet emergjente Lyrja e shtyllave të tensionit të lartë.

ZGJERIMI I SISTEMIT TË LOKALIZIMIT TË DEFEKTEVE NË LINJAT E TENSIONIT TË LART

Ngritja e një sistemi për lokalizimin e avarive në linjat e transmetimit është i një rëndësie të veçantë.

Lokalizimi i avarisë në mënyrë sa më precize në linjat e transmetimit me anë të digital fault locators dhe pasqyrimi i avarisë në sallat e monitorimit është një avantazh shumë i madh për të rritur sigurinë e sistemit energjetik.

Vendodhja e gabimit kërkohet në të gjitha qarqet e ndërlydhura. Lokatori i gabimit jep gabimin në saktësi deri në dhjetra metra afër vendodhjes dhe për të gjitha llojet e defektit të pavaruar nga gjatësia e linjës në linjat ajrore duke filluar nga disa metra deri në 50 km.

Lokatori i gabimit vepron në mënyrë të barabartë në:

- Qarku i hapur, faza në tokë dhe faza në fazë
- Linja me ngarkesa të caktuara
- Linja me ndërtime jouniforme
- Linja me kompensim në seri
- Qarqet DC me njësitë e përshtatshme të bashkimit

Saktësia e lokatorit të gabimeve nuk ndikohet nga:

- Rrymat e gabimeve jo sinusoidale të prodhuara nga arcing
- Zhvillim dhe /ose defekt i paqëndrueshëm
- Kapaciteti i shpërndarë i linjave të gjata.
- Gabimet e CT dhe VT

Lokatorët e defekteve do të jenë të instaluar në menyrë të përhershme dhe do të veprojnë në principin e valës së veprimit..

CYBER HARDENING (DIGITALIZATION) OF SUBSTATIONS(FORTIFIKIMI I NËNSTACIONIT)

Gjatë vitit të kaluar OST sh.a. u angazhua për kryerjen e vlerësimit praktik dhe të detajuar të Rrjetit të tij të Shërbimeve si pjesë e një Vlerësimi të Përgjithshëm mbi Sigurinë Kibernetike të platformave dhe sistemeve kritike e të rëndësishme.

Fokusi kryesor i këtij vlerësimi ishte në Kontrollin dhe Monitorim e Automatizuar (SCADA) të sistemet e menaxhimit dhe komandimit të Aparat Qëndror dhe në nënstacione dhe Shërbimet e kritike të Biznesit siç janë Platforma e Operacioneve të Tregut, Sistemi i Matjes, Infrastruktura IT dhe Infrastruktura e Telekomunikacionit.

Vlerësimi u krye në tre elemente: intervista, verifikim “on-site” dhe përpunimi me mjete të specializuara i të dhënave të grumbulluara në të gjithë infrastrukturën kritike dhe atë të rëndësishme të OST sh.a.

Ne raportin përfundimtar që është paraqitur nga grupi kompanive të kontraktura nga OST sh.a. që beri këto vlerësime paraqiti gjendjen aktuale, nevojat imediate për përmirësim si edhe shtyllat kryesore të një plani transformimi që gjykohej e nevojshme për zbatim me synim

forcimin dhe forcuar mbrojtjen e sigurisë kibernetike të rrjetit operacional të OST sh.a. dhe sistemeve të tjera. Kjo gjë do të mundësoje operim të sigurve të sistemit dhe monitorimin optimal dhe për të lehtësuar aktivitetet nga ndodhja e incidenteve minore apo madhore dhe e reagimit ndaj tyre.

Për t'u vlerësuar është fakti që në kohën kur filloi vlerësimi, OST ka qene në Maturitet 1.0 "Initial level" dhe aktualisht është në Maturitet 1.6, kjo pasi gjatë kohës se zbatimit të projektit janë ndërmarre masa e nevojshme korrigjuese nga Drejtoritë përkatëse në OST në bazë të propozimeve të bëra dhe praktikave me të mira.

Por masat e marra në shume raste nuk janë të mjaftueshme, pasi dhe në gjetjet e evidentuara dhe paraqitura nga kontraktori përfshihet dhe informacion për dobësitë e evidentuara në pjesën e teknologjike operacionale të sistemit (Utility Network), i cili në disa raste ka nevojë urgjente për investime në pajisje, platforma dhe mjete të cilat do të duhet të merren me operimin e sistemit monitorimin, mbrojtjen dhe reagimin ndaj incidenteve apo avarive.

Nga vlerësimi i kryer rezultojnë se nen-stacionet si: Tirana 1; Elbasan 1; Zemblak; Koplik, kanë platforma të sistemeve të SCADA lokale dhe të menaxhimit të mbrojtës Rele shumë të vjetra, në përdorim për më shumë se 10 vjet si dhe në zbatim të normave të amortizimit është e nevojshme të ketë platforma në operim të cilat sigurojnë qëndrueshmëri dhe disponueshmëri. Për t'u theksuar është se këto sisteme kane përfunduar ciklin jetësor teknologjik (end of life support), sipas vendoreve apo prodhues dhe po ashtu janë platforma që mbështeten në sisteme operimi Windows XP, sistem ky që gjithashtu është i nxjerr jashtë suport nga Microsoft.

Kjo do të thotë që në rast dëmtimesh hardware apo software të tyre koha e zëvendësimit dhe riparimit është ose shumë e gjatë, e cila do të sillte vonesa në rikthimin e shërbimeve të ofruara nga këto pajisje, ose deri në mos pasjen mundësi riparimi. Nga ana tjetër këto sisteme dhe platforma teknologjike janë shume vulnerabel për sa i përket pjesës se Sigurisë se Informacionit (Cybersecurity). Sistemi i operimit Windows XP është i pranuar dhe në Microsoft që është vulnerabil tashme dhe duhet zëvendësuar patjetër.

Sa me sipër, gjykohet se është e nevojshme dhe emergjente që të shikohet mundësia për kryerjen e upgrade dhe rritjen e sigurisë në këto nënstacione me objektiv kryesor garantimin e operimit si dhe arritjen e qëllimeve:

- Uljen e mundësive të sulmeve
- Krijimi i shikueshmërisë për komunikimet dixhitale dhe të aktivitetit të pajisjeve
- Për të qënë i gatshëm për integrimin në të ardhmen me Qendrën operative të sigurisë (SOC)
- Lehtësi për përgjigje të shpejte ndaj incidenteve
- Krijimin e mundësive për përditësimin e sistemeve për të përballuar kërcënimet që janë në rritje.

Si përfundim nisur nga rëndësia dhe impaktin që do të kishim në rast të avarive apo incidenteve propozojmë të shikohet mundësia për zbatimin e një projekt pilot: Upgrade dhe fortifikimi i Nënstationit Tirana 1 me qëllim rritjen e sigurisë sipas planit të transformimit.

LINJË E RE 110KV VELIPOJË (KUFÏ MAL I ZI) DHE INSTALIM QARKU 110KV NË LINJËN EKZISTUESE BUSHAT - VELIPOJË

Ndërtimi i linjës 110 kV Kufi – Velipojë, është pjesë e linjës së re që është ideuar të ndërtohet, dhe që do të lidhe N/St e Ulqinit (Mali i Zi) me N/St. e Velipojës (Shqipëri).

Ky segment është pjesë e linjës së re Ulqin (Mali i Zi) – Velipojë (Shqipëri) 110 kV, i cili do të vazhdojë më tej në linjën ekzistuese Velipojë – Bushat, ku do të bëhet edhe lidhja e kësaj linje. Pjesa e linjës N/St. Velipojë – Bushat që shtrihet në territorin shqiptar është një segment i ndërtuar me shtyllëzim, për një rrjet 110kV, çka krijon mundësi praktike për shfrytëzimin e saj, dhe mundëson konkretisht në këtë rast, që të vijohet të shtrohet qarku i dytë me të gjithë elementet e tij për nivelin e tensionit 110 kV nga Velipoja në N/St. e Bushatit.


Për sa më sipër, konsiderohet një bashkëpunim midis dy operatorëve, të dy vendeve Shqipëri dhe Mal i Zi, për ndërtimin e kësaj linje, me një angazhim proporcional.

Zonat e Ulqinit dhe Velipojës, siç dihet, janë dy zona me potencial shumë të madh turistik, dhe sigurimi i infrastrukturës energjetike, do të garantonte ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm turistik të zonave në fjalë.

Gjithashtu, kjo ndërhyrje do të nxisë investimet e reja në hoteleri dhe infrastrukturën turistike dhe duke rritur numrin e bizneseve të vogla e të mesme duke gjallëruar ekonominë lokale në drejtim të shtimit të prodhimeve bujqësore, blegtorale etj.

Nga ana inxhinierike linja që do të ndërtohet do të jete një linjë e re 110kV, me gjatesitë nga kufi deri në N/St. e Bushatit afërsisht me gjatësi rreth 27 km, me përcjellës ACSR-240mm².

Realizimi i kësaj linje do të sjellë ndër të tjera edhe plotësimin e kushtit të sigurisë statike për kriterin n – 1, për Ulqinin në këtë fazë, dhe në një fazë të dytë me zgjerimin e N/St. te Velipojës, futjen në unazë edhe të këtij N/St..



NDËRTIM I LINJËS SË RE ÇOROVODË – KËLCYRË;

Nënstacioni elektrik i Çorovodës është i ndërtuar së fundmi dhe furnizohet me një linjë të re 110kV, me përcjellës ACSR 240/40 mm², që lidhet me nënstationin ekzistues të Uznovës.

Ndërtimi i kësaj linje bëhet i nevojshëm për plotësimin e kriterit të sigurisë N-1 në këtë zonë, mbasi nënstationi i Çorovodës është fundor dhe në këtë zonë ka mjaft burime gjeneruese të lidhur në rrjetin e shpërndarjes (rreth 23 MW) dhe të tjerë që parashikohet të lidhen në zonë.

Ndërtimi i kësaj linje krijon një rrjet unazor të ri, që bën të mundur plotësimin e kriterit të sigurisë N-1.

Linja e re do të jetë me një qark, me përcjellës ACSR240/40 mm², me gjatësi rreth 30 km dhe në këtë projekt është parashikuar gjithashtu shtimi i një trakti në nënstationin Këlcyrë dhe punime sistemi në nënstationin 110 kV Këlcyrë.




Fig. 1 Diagrama njëfazore e linjës së re 110kV Çorovodë-Këlcyrë.

NDËRTIMI I LINJËS SË RE 110KV GJIRI I LALZIT- PORTO ROMANO

Ndërtimi i N/stacionit të Gjirit të Lalzit 110/20kV nga operatori i shpërndarjes OSHEE sh.a dhe në kuadër të bashkëpunimit të dyanshëm, nga ana e OST u ndërtua linja 110kV nënstationi Sallmone- Gjiri i Lalzit si dhe një shtesë trakti në N/stacionin Sallmone e cila u vu në operim në vitin 2020.

Zona e Gjirit të Lalzit mbart potenciale të mëdha turistike dhe ndërtimi i infrastrukturës së re energjitike do të nxisë investimet e reja në hoteleri dhe infrastrukturën turistike duke nxitur rritjen numrin të bizneseve të vogla e të mesme dhe gjallërimin e ekonomisë lokale në drejtim të shtimit të prodhimeve bujqësore, blegtorale etj.

Gjithashtu do të shërbejë për rritjen e kapaciteteve të mundshme pritëse për burimet e rinovueshme të energjisë sidomos për impiantet solare etj, ku më konkretisht, në vijim të ankandit për ndërtimin e një parku fotovoltaik në zonën e Spitallës e shpallur si një zonë me potencial të lartë diellor, është përcaktuar kompania fituese e cila do të ndërtojë një central fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100MW brenda një të ardhme të afërt, i cili planifikohet të lidhet në anën 110kV të Nstacionit Porto Romano.

Për vetë rëndësinë që ka operimi i N/stacionit Gjiri i Lalzit është e nevojshme furnizimi i tij me një linjë të dytë për të përmbushur kriterin e sigurisë statike N-1 dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

Parashikohet ndërtimi i një linjë të re 110kV nënstationi Gjiri i Lalzit-P.Romano me gjatësi 20km me përcjellës ACSR-240mm².

Realizimi i kësaj linje do të sjellë operimin në unazë të të dy nënstationeve si nënstationi P.Romano dhe nënstationit të Gjiri i Lalzit të cilat aktualisht punojnë të lidhur me linja radiale pa mundësi rezervimi nga një burim i dytë energjie.




Fig. 2 Lidhja e Nënstationeve Gjiri i Lalzit dhe Porto Romano me një linjë të re 110kV

RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 220KV TË INTERKONJEKSIONIT SHQIPËRI (VAU I DEJËS) – MALI I ZI (PODGORICË);

Ndërtimi i kabllit të planifikuar HVDC midis Italisë dhe Malit të Zi do të mundësojë evakuimin e tepër të gjenerimit të ardhshëm në zonën e Ballkanit dhe në të njëjtën kohë do të sjellë forcimin e mëtejshëm të rrjetit të transmetimit në rajon.

Shumë iniciativa të reja për ndërtimin e centraleve të burimeve të rinovueshme janë duke u zhvilluar në veri të Shqipërisë dhe për këtë arsye nevojiten përf forcime të linjave ekzistuese të interkonjeksionit për të siguruar shkëmbimet ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Linja ajrore aktuale e interkonjeksionit Vau i Dejës (Shqipëri) - Podgorica (Mali i Zi) është ndërtuar në 1972 dhe ka një kapacitet të fuqisë së transmetueshme rreth 278 MVA.

Projekti përfshin:

Rikonstrukcionin e linjës ajrore 220 kV Vau i Dejes - Koplík (AL) - Podgoricë me një linjë të re ajrore me qark të dyfishtë, afërsisht 45 km e gjatë me përcjellës të llojit alumin-çelik 490/65 mm².

Përfitimet që arrihen nga kryerja e këtij investimi janë:

- Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së rrjetit shqiptar dhe të Malit të Zi
- Rritja e shkëmbimit ndërkufitar midis dy vendeve
- Rritja e Kapaciteteve Neto të Transferimit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi në dritën e shkëmbimeve të energjisë elektrike midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë nën shkëmbimet e sigurisë
- Reduktimi i konxhestioneve të rrjetit
- Përmirësimi e cilësisë së furnizimit me energji elektrike
- Një ulje të humbjeve teknike
- Reduktimin e niveleve të CO₂

NDËRTIMI I NJË LINJE TË RE AJRORE 110KV NDËRMJET SHQIPËRISË (NST BAJRAM CURRI) DHE KOSOVËS (NST DEÇAN);

Ky projekt vjen në kuadër të marrëveshjeve e memorandumeve të nënshkuara ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë në fushën energjitike si dhe nën bashkëpunimin ndërmjet dy kompanive të transmetimit OST dhe KOSTT si një proces i vazhdueshëm dhe shumë planësh në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale që këto operatorë mbulojnë, marrëveshjeve dypalëshe në fuqi dhe detyrimeve që lindin nga asociimi i përbashkët në nisma rajonale dhe jo vetëm.

Duke parë potencialin e lartë gjenerues hidrik por dhe të burimeve të tjera të rinovueshme që priten të lidhen në zonën verilindorë të vendit po studiohet mundësia e lidhjes me një linjë interkonjeksioni 110kV në formë unaze nga kjo zonë e Shqipërisë drejt zonave me konsum të lartë të Kosovës si Deçan, Prizren etj.

Në këtë menyrë do të shfrytëzohet fakti i diversifikimit të prodhimit të energjisë kur dihet se Kosova bazohet mbi prodhimin me linjit.

Potencialisht, kjo do të sjellë ulje të mundshme të kostove të prodhimit nga gjeneruesit e të dy vendeve dhe blerjen e humbjeve nga operatorët e sistemit të transmetimit me kosto sa më të ulët. Diversifikimi do të bëjë të mundur administrimin më të mirë të shërbimeve ndihmëse, duke përthithur mirë disbalancimin që do vijë nga shtimi i burimeve të rinovueshme.

Zona e Bajram Currit dhe më gjerë përfaqëson pikën më verilindore të Shqipërisë. Kjo zonë karakterizohet përgjithësisht nga nivele relativisht të ulëta të popullsisë dhe të kërkesës për energji elektrike, por për shkak të terrenit të përshtatshëm dhe kushteve hidrologjike të favorshme, zotëron një potencial të lartë të zhvillimit të burimeve gjeneruese hidrike. Për më tepër, kjo zonë përfaqëson një nga rajonet kryesore të turizmit malor në vend dhe si e tillë lind

nevoja për garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike si kusht për zhvillimin e industrisë turistike, punësimit dhe infrastrukturës lokale.

Nënstacionet kryesore që furnizojnë me energji elektrike rrjetin e shpërndarjes së zonës janë nënstationet 110/10 kV Gropaj dhe 110/20/10 kV Bajram Curri. Rrjeti i transmetimit në zonë përbëhet nga linja 110 kV Fierzë – Gropaj – B.Curri që lidh nënstationet e lartpërmendur me nënstationin 220/110 kV Fierzë. Ndërkohë, linja 110 kV Fierzë – Gropaj – B.Curri është një linjë radiale, e palidhur në konfigurim unazor. Linja është ndërtuar me përcjellës Al me seksion 120 mm², që siguron një kapacitet transmetues prej 73 MVA, duke limituar në këtë mënyrë numrin dhe fuqinë e centraleve të rinj gjenerues që mund të integrohen në rrjet në këtë zonë. Kjo problematikë bëhet më e theksuar duke pasur parasysh se hidrocentralet në zonë janë të llojit me derivacion (run of river) dhe në periudhat me prurje të larta janë të detyruara ta injektojnë të gjithë energjinë në rrjet pa pasur mundësi rezervimi dhe duke vështirësuar ndjeshëm operimin e rrjetit tashmë të amortizuar.

Për më tepër, konfigurimi radial nënkupton se stakimi i një prej segmenteve të linjës 110 kV B.Curri-Gropaj-Fierzë detyrimisht lë NS Gropaj dhe B.Curri pa mundësi furnizimi me energji elektrike, duke sjellë kështu dhe mosplotësimin e kriterit të sigurisë statike N-1. Linja 110 kV B.Curri-Gropaj-Fierzë është ndërtuar në vitin 1973, me një periudhë operimi prej gati 50 vjetësh, fakt ky që rrit ndjeshëm shkallën e amortizimit të linjës dhe mundësinë e stakimeve të shpeshta të saj, duke sjellë në këtë mënyrë dhe rritjen e energjisë së mosfurnizuar konsumatorëve në zonë apo gjenerimit të kufizuar.

Rrjedhimisht problematikat kryesore që paraqiten dhe synohet të zgjidhen nga pikëpamja e rrjetit në Shqipëri janë plotësimi i kriterit N-1 për rrjetin e transmetimit në zonë dhe integrimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, nëpërmjet lidhjes së nënstationit fundor B.Curri me rrjetin për të krijuar një konfigurim të ri unazor.

Konfigurimi i rrjetit i krijuar në këtë rast është mbyllja e unazës 110 kV: Fierza-B.Curri-Deçan-Gjakova1&2-Prizren2-Dragash-Kukës-Kalimash-Lajthizë-F.Arrëz-Fierzë, sipas diagramës njëfazore të paraqitur:




Fig. 3 Skema njëfazore e lidhjes së linjës 110kV Bajram Curri-Deçan

Furnizimi radial i konsumit të Bajram Currit nuk krijon siguri të furnizimit për konsumatorët e asaj zone, gjithashtu një siguri të cënuar kanë edhe HEC-et e lidhura në këtë nënstacion, prandaj krijimi i lidhjes unazore përmes linjës interkonektive 110 kV Bajram Curri - Deçan rrit sigurinë e furnizimit.

Ky projekt do të rrisë sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike duke reduktuar jo vetëm orët e ndërprejes së konsumatorëve familjarë por edhe orët e mos transmetimit të energjisë nga ana e gjeneruesve, përmirësim të niveleve të tensionit dhe reduktim të humbjeve. Linja e re 110kV do të jetë me përcjellës me seksion 240mm² me gjatësi totale rreth 33km, ku 14 km në territorin e Shqipërisë dhe 19 km linjë kalojnë në territorin e Kosovës.

NDËRTIMI I NJË LINJE TË RE AJRORE 110KV NDËRMJET SHQIPËRISË DHE MAQEDONISË SË VERIUT;

Qëllimi i këtij projekti është orientimi i flukseve të energjisë të prodhuara kryesisht nga burimet e rinovueshme në Shqipëri, direkt drejt rajonit të Maqedonisë së Veriut që shfaqin një konsum më të lartë të energjisë elektrike. Gjatësia e linjës është rreth 43.7 km dhe do të sigurojë një kapacitet transmetimi shtesë rreth 123 MVA.

Përfitimet që arrihen nga kryerja e këtij investimi janë:

- Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së rrjetit shqiptar dhe të Maqedonisë së Veriut
- Reduktimi i konxhestioneve të rrjetit
- Përmirësimi e cilësisë së furnizimit me energji elektrike
- Reduktimin e niveleve të CO₂

NDËRTIMI I LINJËS SË RE 110KV HEC LURË- SHUMAT;

Rrjeti elektrik në segmentet Fierzë – Fushë Arrëz – Kukës – Lapaj – Peshkopi – Bulqizë – Burrel përfaqëson një unazë 110 kV me një shtrirje në të gjithë zonën verilindore të vëndit, në të cilën janë lidhur dhe janë në proces ndërtimi një numër i madh HEC-esh me fuqi të përgjithshme 281 MW.

Për të rritur kapacitetin transmetues, rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike të zonës nga ana e OST janë në proces zbatimi projektet :

- Ndërtimi i linjës së re 220 kV Burrel – Peshkopi dhe trakti dalës në Nstacionin e Burrelit.
- Ndërtimit të nënstacionit të ri 220/110/35 kV Shumat, dhe i traktit 220kV në Nstacionin e Burrelit.

Të dy investimet priten të sjellin një impakt të madh në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe përmirësimin e profilit të tensionit. Vënia në shfrytëzim e këtyre projekteve do të garantojë operimin optimal të burimeve hidrike të zonës dhe një furnizim cilësor për konsumatorët.

Në kuadër të fuqizimit të unazës verilindore dhe paralelisht me ndërtimin e nëstacionit 220/110/35kV planifikohet realizimi i një linje 110kV me dy qarqe me gjatësi 23km e cila do të shërbejë për lidhjen e nënstacioneve të HEC Lurës dhe të anës 110kV të Nstacionit të Shumatit.

Aktualisht nënstacioni i HEC Lurës operon në mënyrë radiale dhe i lidhur me sistemin vetëm me linjën 110kV L-110-46 e cila përfundon në nëstacionin e Kurbneshit i cili nga ana e tij është i lidhur me sistemin me anë të linjës 110kV L-110-3 e cila përfundon në anën 110kV të HEC Ulëz siç paraqitet në figurën e mëposhtme:




Fig. 4 Skema ekzistuese e lidhjes së Nënstacioneve Kurbnesh dhe Shutri si dhe gjeneruesit e lidhur në këtë skemë




Fig. 5 Linja e re 110kV Nstacioni HEC Lure- Shumat

RIKONSTRUKSION I LINJËS FIER-KAFARAJ-VLORA1

Të favorizuar nga pozicioni gjeografik i zonës Fier, Vlorë dhe vlerave relativisht të larta të orëve vjetore me rrezatim diellor të konsiderueshëm, është shtuar ndjeshëm interesi i investitorëve në ndërtimin e parqeve fotovoltaike për gjenerimin e energjisë elektrike në këtë zonë. Kjo situatë është reflektuar në faktin se gjatë dy viteve të fundit ka patur një numër të lartë të aplikimeve për lidhje të centraleve fotovoltaike në rrjetin e transmetimit në rajonin Lushnjë-Fier-Vlorë. Zona e Fierit, së bashku me zonën e Spitallës në Bashkinë Durrës është shpallur zonë me potencial të lartë të rrezatimit diellor nga MIE duke qenë një zonë prioritare për përmbushjen e politikës së diversifikimit të burimeve energjitike në vend.

Referuar ecurisë së deritanishme të aplikimeve për lidhje të reja, kapaciteti gjenerues i centraleve PV që planifikohen të lidhen në këtë zonë është rreth 1 GW.

Si pasojë e distancave të afërta dhe kufizimit eventual të hapësirës së lirë në anën 110 kV dhe 220kV të Nstacionit Fier, një pjesë e konsiderueshme e centraleve PV janë orientuar për lidhje me rrjetin e transmetimit në nënstacionet Kafaraj dhe Vlora1.

Linja ekzistuese është ndërtuar në vitin 1966 me përcjellës AC-95 mm² dhe AC-120 mm² dhe me kapacitet të kufizuar rreth 73MW të transmetimit të energjisë elektrike.

Në kushtet aktuale nuk është e mundur plotësimi i kriterit të sigurisë N-1, në rast stakimi të ekstremiteteve të linjës 110 kV. Rikonstruksioni i kësaj linje tashmë është bërë i domosdoshëm pavarësisht nga burimet e reja që mund të lidhen në të.

Fuqizimi i linjës do të realizohet nëpërmjet ndërtimit të një linje të re 110kV me dy qarqe me përcjellës ACSR 240/40 mm², rreth 28 km e gjatë.

Linja do të rrisë ndjeshëm kapacitetin akomodues të zonës dhe do të shërbejë për shpërndarjen optimale të burimeve të reja të rinovueshme të zonës.

Në figurën më poshtë jepet paraqitja skematike e ndërtimit të kësaj linje.




Fig. 6 Diagrama njëfazore e linjës Fier- Kafaraj – Vlora1 që do të rikonstruktohet

Kostot Kapitale

Kostot kapitale të OST sh.a. sipas metodologjisë përlloraritën:

$$C_{kapitale} = R + D$$

- R** Kthimi mbi bazën e rregulluar të asetëve
D Amortizimi i asetëve fikse dhe amortizimi i asetëve të tjera

$$R = B \times WACC$$

- B** Aseti Bazë i Rregulluar në fillim të vitit bazë të ciklit të vlerësimit të tarifave
WACC Norma e lejueshme e kthimit të Asetit Bazë të Rregulluar.

Llogaritja e Asetit Bazë të Rregulluar (**B**) në fillim të vitit bazë 2023 (Vlera në fund të vitit 2022) është kryer duke llogaritur kapitalizimin e të gjitha investimeve në proces deri më 31.12.2022.

Për vitin 2023 amortizimi i parashikuar pritet të jetë rreth 2,831 milionë lekë ndërsa Aseti Bazë i Rregulluar (RAB) në fillim të vitit 2023 është rreth 36,733 milion lekë.

Rezultatet e përlloraritjeve për vitet 2023-2025, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Viti	RAB në fillim të periudhës	Investimet	Amortizimi	RAB në fund të periudhës
2022	35,808	3,177	2,252	36,733
2023	36,733	6,496	2,831	40,398
2024	40,398	7,368	2,930	44,836
2025	44,836	3,152	2,938	45,051

Sipas metodologjisë norma e lejueshme e kthimit për Asetin Bazë të Rregulluar është:

$$WACC = \left[ES \times \frac{ARoE}{1 - T} \right] + (DS \times CoD)$$

- ES** Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB
T Norma e taksës së korporatës (Tatim-fitimi)
ARoE Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse
DS Objektivi për raportin e borxhit në RAB
CoD Kosto e borxhit
ARoE - Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazën e nevojës së OST-se për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë.
CoD - Kosto e borxhit – norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është përcaktuar si shuma e pagesave të interesit mbi borxhin afatgjatë gjatë vitit baze, pjesëtuar me principalin total mbi borxhin afatgjatë (shuma totale e marrë borxh) në fillim të vitit bazë.

Në përlloraritjen e tarifave për periudhën 2023-2025, është marrë ne konsideratë vlera e **WACC = 2.28 %**, vlerë e cila është përlloritur nga ERE në Vendimin Nr. 72, datë 13.04.2022.

Gjëndja e Huave Afatgjata të OST sh.a., deri në fund të muajit Qershor 2022, si dhe vlerësimet për kostot e tyre për periudhën 2023-2025, gjenden aneks më vete, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

Pjesa e prapambetur e detyrimeve për kredi afatgjata, deri në fund të muajit Qershor 2022, është 15,193 milionë lekë, nga të cilat 9,960 milionë lekë janë detyrime ndaj MFE dhe 5,232 ndaj KESH sh.a. Detyrimi për pagesën e këtyre kredive të prapambetura është i OSHEE sipas vendimit të ERE nr. 190, datë 22.12.2016.

OST i përdor fondet e siguruar nga kreditë afatgjatë ekskluzivisht për investimet e reja kapitale.

Gjatë viteve të fundit OST është angazhuar kredi afatgjata për të financuar projekte madhore për zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

B. Kostot operuese

$$C_{operuese} = C_{matje} + C_{mirëmbajtje} + C_{personeli} + C_{energjie} + C_{shërbime\ me\ të\ tretë} + C_{taksë}$$

C_{matjes}	kosto e matjes së energjisë elektrike dhe energjisë së lëvruar tek klientët e sistemit të transmetimit dhe kosto e faturimit dhe likuidimeve të llogarive me përdoruesit e sistemit të transmetimit. Këto kosto lidhen me kostot e shkaktuara nga klientët, por nuk përfshijn koston e matjes së humbjeve të energjisë elektrike, konsumin e energjisë elektrike për qëllime teknologjike dhe eksportin, importin dhe fluksin e tranzitit. Kostot e matjes janë të përfshira në kostot e tjera operuese të OST sh.a., respektivisht në kostot e pagave dhe mirëmbajtjes;
$C_{mirëmbajtje}$	pjesë zëvendësimi, furnizime, mjete, lëndë djegëse dhe kosto të tjera mirëmbajtje;
$C_{personeli}$	pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe kostot (Të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve;
$C_{energjie}$	kostot për mbulimin dhe prokurimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, pagesa për blerjen e shërbimeve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, kostot e ridispeçimit, kostot e ITC;
$C_{taksë}$	Komponenti që mundëson që rregullatori të tregojë qartë pjesën e tarifës që atribuohet taksave dhe prandaj është përtej kontrollit të rregullatorit. Komponenti takse të ardhurave të synuara të OST-se për vitin baze, nuk përfshijn TVSH-ne dhe tatimin mbi fitimin.

Në llogaritjen e tarifës së transmetimit, kosto për humbjet janë llogaritur duke u bazuar në çmimet e tregut:

$$C_{humbje} = E_{humbje} \times Ph$$

E_{humbje}	humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit gjatë vitit bazë
Ph	çmimi mesatar i energjisë elektrike që do të blihet në treg për mbulimin e humbjeve gjatë vitit bazë.

Për periudhën 2022-2025, kostot operative të parashikuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	Njësia	2022	2023	2024	2025
Personeli	Mln ALL	1,330	1,399	1,425	1,454
Sherbime administrative e te tjera	""	557	655	610	614
Materiale të para	""	103	133	143	153
Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim	""	0	720	792	864
Blerja e sherbimeve ndihmese	""	906	1,843	2,012	2,120
Blerja e humbjeve	""	4,196	14,116	8,622	5,850
Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	""	250	300	300	300
TOTALI i Kostove Operative	Mln ALL	7,341	19,166	13,904	11,355

Në mënyrë të detajuar, kostot operative të parashikuara për vitin 2023, po i paraqesim si më poshtë:

✓ **Shpenzimet e Personelit**

Shpenzimet e personelit janë parashikuar duke konsideruar historikun dhe ecurinë aktuale të zërave të kostove të personelit, në përputhje të plotë me strukturën organizative të OST sh.a.. Në përputhje me strukturën aktuale të OST sh.a., për vitin 2023, numri i punonjësve të OST sh.a. është 806 persona dhe shpenzimet totale për personelin janë parashikuar 1,399 milion leke.

Shpenzimet e Personelit		
Fondi i pagave	mln ALL	813
Pagesa për turne dhe orë jashtë orarit	"	47
Shpenzime ushqimi për punonjësit	"	95
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	"	32
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	"	161
Shpenzime page për vjetërsi në punë	"	91
Fondi suplementar i pensionit	"	39
Shpenzime te tjera Personeli	"	45
Paga 13	"	75
Totali	mln ALL	1,399
Nr. mesatar i punonjësve	Nr	806
Paga mesatare	ALL	84,107

Për vitet 2024 dhe 2025, kostot e personelit janë parashikuar duke u indeksuar me një rritje rreth 2% në vit.

✓ **Shërbimet administrative e të tjera**

Në këtë zë përfshihen Shërbimet me fondet e veta për vitin 2023 si dhe shpenzimet periodike që OST sh.a. kryen për funksionimin e saj (si psh: mirëmbajtja e platformave dhe sistemeve të ndryshme të operimit, mirëmbajtja e godinave, mirëmbajtja e automjeteve, ruajtja e objekteve, shpenzimet e kryera nga të tretë për shërbime dhe mirembajtje, ujë, siguracione, pagesat e ERE etj). Për vitin 2023, janë parashikuar rreth 655 milione lekë për këto shërbime të domosdoshme për OST sh.a.. Në mënyrë më të detajuar, paraqiten si më poshtë:

Nr	Shërbime administrative e të tjera	Milione Leke
1	Organizma Rajonale	110
2	Mirembajtje platforma dhe sisteme SOFTWARE	110
3	Ruajtje Objekte	147
4	Cyber Security	10
5	Mirembajtja e automjeteve	30
6	Trainime per punonjesit	20
7	Kerkime studime	35
8	Eksperte Kontabel dhe Vleresues	30
9	Sherbim Teknik me jashte, aplikime, pjesmarrje	10
10	ERE	20
11	Kompesimi i disbalancave në rast të ndërprerjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit si pasojë e avarive në sistem*	26
12	Sherbimi i aksesit ne OST	10
13	Studime per perpunimin e te dhënave të matjes	40
14	Automjete me qera	12
15	Sherbime te tjera	45
TOTAL		655

Per vitet 2024 dhe 2025, këto shpenzime janë parashikuar të jenë përkatësisht 610 milionë lekë dhe 614 milionë lekë.

*** Kompesimi i disbalancave në rast të ndërprerjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit si pasojë e avarive në sistem:**

Vendimi Nr 106 /2020 ERE “Mbi Miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” parashikon se kompensimi i disbalancave të cilat shkaktohen nga shkëputja e përdoruesve të lidhur në Rrjetin e Transmetimit, në raste të avarive në rrjet, duhet të mbulohet nga OST. Energjia e munguar si pasojë e avarive të shkaktuara në rrjetin e OST, për të cilën përdoruesit duhet të kompesohen janë përlllogaritur duke marrë në konsideratë eksperiencën shumë vjecare të menaxhimit të sistemit por gjithashtu edhe referuar të dhënave statistikore të mbajtura nga OST për vitin 2022.

Nga eksperiencia e deritanishme rezulton se sasia e energjisë së ‘munguar’ që duhet të kompensohet është e rendit 2,178 MWh në vit.

Përdoruesi konsumator (**Furnizuesi si PPB i cili ka një kontratë furnizimi me përdoruesin konsumator**) nuk penalizohet me disbalance pozitive, por kompensohet nga OST me cmimin e blerjes së energjisë nga furnizuesi përkates.

Përdoruesi gjenerues nuk penalizohet me disbalance negative. Disbalanca e krijuar mbulohet nga OST.

Viti	Sasia e energjisë që duhet të kompensohet nga OST [MWh]	Cmimi mesatar [€/MWh]	Fondi [€]	Fondi [Mln Leke]
2023	2,178	100.00	217,800	26.1
2024	2,000	110.00	220,000	26.4
2025	1,800	120.00	216,000	25.9

✓ **Menaxhimi i kongestionit me ridispecim**

Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për dispeçerimin e energjisë elektrike nga centralet prodhuese në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike. Aktet rregullatore në fuqi, Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike miratuar me Vendimin ERE 106/2020 dhe Kodi i Transmetimit i miratuar me Vendimin ERE 63 datë 11.04.2022, i jep detyrimin OST të kompesojë përdoruesit e rrjetit të cilët në bazë të kërkesës së bërë nga OST (ulin ose rrisin gjenerimin në një pikë të caktuar të injektimit në rrjet, për të ciluar konxhestionet).

Për të ciluar konxhestionin në rrjet, në rastet kur shfaqet, aplikohet ridispecimi, që nënkupton uljen e gjenerimit në një pikë të caktuar të injektimit në rrjet, dhe rritjen respektive të gjenerimit në një pikë tjetër të injektimit në rrjet, ose sipas rastit vetëm uljen apo rritjen e gjenerimit në funksion të konxhestionit të krijuar. Ky ndryshim i gjenerimit, krahasuar me programin e kontraktuar që ka deklaruar pjesmarrësi përkatës në treg, duhet të kompensohet nga OST, si në rastin e uljes, ashtu edhe në rastin e rritjes së gjenerimit, për një periudhë të caktuar kohore që vlerësohet nga Operatori.

Për përmasat e Sistemit tonë është vlerësuar i mjaftueshëm kapaciteti prej 100 MW (± 50 MW). Numri i diteve potencialisht të mundshme për aplikimin e ridispecimit është marrë 100, dhe me një kohëzgjatje të mundshme prej 6 orë, për cdo rast ridispecimi. Cmimi i këtij lloji shërbimi është marrë i përafërt me cmimin e injektimit të energjisë nga PPE-te me koncension.

Viti	Kapaciteti [MW]	Nr. Ditëve	Kohezgjatja në ore per çdo ditë të mundshme	Sasia [MWh]	Cmimi mesatar [€/MWh]	Fondi [€]	Fondi [Mln Leke]
2023	100	100	6	60,000	100.00	6,000,000	720
2024	100	100	6	60,000	110.00	6,600,000	792
2025	100	100	6	60,000	120.00	7,200,000	864

✓ **Materiale të para**

Shpenzimet e materialeve përfshijnë të gjitha materialet që përdoren në mirëmbajtjen e linjave, nën-stacioneve, godinave, karburanti dhe kancelaritë. Në llogaritjen e vlerës së këtij zëri jemi nisur nga realizimet faktike disa vjecare, programin e realizimit e pritshëm për vitin 2022 si dhe në kërkesat kryesore të Njesive, për kryerjen e aktivitetit normal të punës së tyre. Për vitin 2023 shpenzimet për materiale të para parashikohet të jenë 133 milionë lekë. Në mënyrë më të detajuar, paraqiten si më poshtë:

Materiale të para		
Blerje Lëndë djegëse.	ALL	50,000,000
Blerje Kancelarie	ALL	3,000,000
Blerje materiale per Njesite Operative	ALL	80,000,000
TOTAL	ALL	133,000,000

Për vitet 2024 dhe 2025, këto shpenzime jane parashikuar të jenë përkatësisht 143 milionë leke dhe 153 milionë lekë.

✓ **Prokurimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit**

Në bazë të Ligjit Nr. 43/2015 për sektorin e energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.

Në lidhje me trendin e cmimeve të energjisë elektrike për periudhën 2023-2025 në treg janë konstatuar luhatje të vazhdueshme të cmimeve. Konflikti (lufta) Rusi-Ukraine, ka patur dhe vijon të ketë një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e cmimit të gazit, naftës dhe energjisë,. Nga analiza e këtyre faktoreve pritet një rritje e cmimit të energjisë elektrike deri në 2030.

Për vitin 2023, humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 210 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, dhe bazuar në të dhënat e HUPX është konsideruar çmimi mesatar vjetor prej rreth 559.72 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 118 milion euro ose 14,116 milionë lekë.

Për vitin 2024 humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 215 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me baze tregu, dhe bazuar në të dhënat e HUPX është konsideruar çmimi mesatar vjetor prej rreth 334.19 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 72 milion euro ose 8,622 milionë lekë.

Për vitin 2025 humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 220 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, dhe bazuar në të dhënat e HUPX është konsideruar çmimi mesatar vjetor prej rreth 221.60 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 49 milion euro ose 5,850 milionë lekë.

✓ **Prokurimi i kapacitetit rregullues dhe atij rezervë për shërbimin e balancimit**

Në bazë të Kodit të Transmetimit dhe Manualit të Operimit të ENTSO-E (SO-GL), OST duhet të prokurorë rezervën balancuese të nevojshme për ruajtjen e balancës të zonës së kontrollit në mënyrë të vazhdueshme. Rezerva balancuese përbëhet nga rezerva primare (FCR) dhe ajo sekondare automatike (aFRR) dhe manuale (mFRR).

Kështu në kushtet e prokurimit të rezervës në bazë tregu duke patur parasysh hyrjen në fuqi të Tregut Balancues nga një mesatare e çmimeve rezultuar deri më tani si dhe çmime të rajonit, fondi që kërkohet për blerjen e këtij shërbimi është rreth 15.75 milion euro. Ndërsa për vitet në vijim referuar dhe tabelave si më poshtë, parashikohet për vitin 2024 një fond rreth 16 milion euro, për vitin 2025 një fond rreth 15.65 milion euro.

Produkti	Viti 2023			Viti 2024			Viti 2025		
	Sasia [MW]	Çmimi mesatar [€/MW]	Fondi [€]	Sasia [MW]	Çmimi mesatar [€/MW]	Fondi [€]	Sasia [MW]	Çmimi mesatar [€/MW]	Fondi [€]
FCR+	70,080	20.54	1,439,443	78,840	18.49	1,457,752	87,600	16.64	1,457,664
FCR-	70,080	20.54	1,439,443	78,840	18.49	1,457,752	87,600	16.64	1,457,664
aFRR+	350,400	13.29	4,656,816	434,350	11.96	5,194,826	478,150	10.77	5,149,676
aFRR-	302,950	13.19	3,995,911	354,050	11.87	4,202,574	390,550	10.68	4,171,074
mFRR+	657,000	4.99	3,278,430	657,000	4.49	2,949,930	657,000	4.04	2,654,280
mFRR-	219,000	4.28	937,320	219,000	3.85	843,150	219,000	3.47	759,930
Σ	1,669,510	9.43	15,747,363	1,822,080	8.84	16,105,983	1,919,900	8.15	15,650,288

✓ Shpenzimet për ITC

Për përcaktimin e vlerës së ITC për vitin 2021 janë marrë në konsideratë të dhënat disavjecare të pagesave për kete ze. Këto pagesa janë në proporcion të drejtë me marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera. Mekanizmi tek i cili bazohet llogaritja e ITC është “PAN-EUROPEAN INTER-TSO COMPENSATION MECHANISM”. Ky mekanizëm është projektuar për të kompensuar palët për shpenzimet që lidhen me humbjet që rezultojnë nga bartja e flukseve të energjisë në sistemet e tyre. Duke ndjekur trendin disavjecar të ITC si dhe parashikimin e energjise, shpenzimet për CBT parashikohet të jenë rreth 300 milionë lekë për çdo vit.

C. Të ardhurat nga aktivitete të tjera

Në vlerësimet e treguesve për periudhën 2023-2025, nga ana e OST sh.a., janë parashikuar dhe të ardhura të tjera të cilat nuk vijnë nga aktiviteti i shërbimit të transmetimit, dhe këto të ardhura merren në konsideratë dhe zbriten nga të ardhurat e kërkuara në përlogaritjen e tarifës së transmetimit. Këto të ardhura parashikohen si në tabelën e mëposhtme:

Të ardhura nga Aktivitete të tjera	Njesia	2023	2024	2025
Alokimi i kapaciteteve	Mln Leke	1,318	1,360	1,331
Të ardhura nga telekomunikacioni	“”	60	70	80
Te ardhura nga Grantet	“”	50	50	50
Te Ardhura te Tjera	“”	5	5	5
Totali i të ardhurave nga aktivitete të tjera	Mln Leke	1,433	1,485	1,466

VIII. Tarifa aktuale

Me vendimin Nr. 72, datë 13.04.2022 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022-2024”, Enti Rregullator i Energjisë, ka miratuar tarifën mesatare të transmetimit në masën 0.85 lekë/kWh për periudhën rregullatore 1 maj 2022 - 31 dhjetor 2024, tarifë e cila edhe pse u rrit me rreth 13% nga tarifa e mëparshme, rezulton të jetë rreth 40% më e ulët nga ajo çfarë kishte kërkuar OST sh.a. në aplikimin e saj.

Duke marrë në konsideratë të dhënat më të fundit për rezultatin e pritshëm të vitit 2022, të ardhurat e kërkuara dhe tarifa e nevojshme që do të duhej, pasqyrohet si mëposhtë:

Emertimi	Njesia masese	2022
Konsumi	GWh	7,686
Çmimi i blerjes se Energjise humbjet	EUR/MWh	169.91
Vlera e humbjeve	EUR	35,143,490
Vlera e humbjeve	Mln leke	4,196
C Operuese	Mln leke	7,341
Energjia	Mln leke	5,351
- Humbjet	"	4,196
- Sherbimet Ndihmese	"	906
- ITC	"	250
Kosto shfrytezimit	Mln leke	1,989
- Personeli	"	1,330
- Materiale	"	103
- Furnitura & Sherbime	"	557
Investimet e vitit	Mln leke	3,177
D - Amortizimi	Mln leke	2,252

Emertimi	Njesia masese	2022
B - Baza e rregulluar e asetëve	Mln leke	35,808
WACC (sipas Vendimit të ERE për tarifen 2022-2024)	%	2.28%
R - Kthimi mbi kapitalin (R = B*WACC)	Mln leke	816
C kapital= R+D	Mln leke	3,068
C - Ardhurat kerkuara (C operuese + C kapital)	Mln leke	10,409
Te ardhurat nga aktivitetet tjera	Mln leke	1,762
Ardhurat kerkuara neto	Mln leke	8,646
Tarifa mesatare e transmetimit	Leke/kWh	1.12

Nga vlerësimet e pritshme për vitin 2022, mbështetur në metodologjinë e tarifave të transmetimit, tarifa e përlogaritur për vitin 2022 duhet të jetë 1.12 lekë/kWh nga 0.85 lekë/kWh që është miratuar.

Të ardhurat e munguara për vitin 2022 sipas përlogaritjeve janë 2,113 milionë lekë:

$(1.12 \text{ lekë/kWh (tarifa e duhur)} - 0.85 \text{ lekë/kWh (tarifa e miratuar)}) = 0.27 \text{ lekë/kWh (kompensimi i kërkuar)}$,
 $(0.27 \text{ lekë/kWh (kompensimi i kërkuar)} * 7,686 \text{ GWh (sasinë e konsumit)}) = 2,113 \text{ milionë lekë (të ardhurat e munguara)}$

Vlera e të ardhurave nga tregu i balancimit për vitin 2022, pritet të jetë rreth 1,617 milionë lekë.

Njohja e tyre, do të kishte një ndikim neto në shtimin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2022, në një vlerë prej 497 milionë lekë. $(2,113 - 1,617 = 497)$.

IX. Llogaritja e Tarifave

Duke marrë në konsideratë;

- Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit;
- Realizimin faktik të treguesve për periudhën Janar-Qershor të vitit 2022;
- Pritshmërinë e realizimit të treguesve për vitin 2022;
- Vlerësimet e treguesve dhe parashikimin e tyre për vitet 2023-2025;
- Sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të OST sh.a.;
- Minimizimin e ndikimeve tek konsumatorët dhe operatorët e tjerë;

OST sh.a. ka bërë përlogaritjet për të ardhurat e kërkuara dhe tarifat e transmetimit të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të vet normal për vitet 2023-2025 sipas dy metodave të përcaktuara në metodologji:

1. Tarifa me një nivel (Tarifa mesatare e transmetimit, siç është deri tani)
2. Tarifa me dy nivele (sipas komponenteve: Kapacitet dhe Energji).

Në mënyrë të detajuar, përlogaritjet sipas dy metodave të mërcaktuara në metodologji, pasqyrohen në vijim:

IX.1 Llogaritja e Tarifës me një nivel - Tarifa mesatare e transmetimit

Duke u mbështetur në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, OST sh.a. ka bere vleresimet sipas tabelës në vijim.

Emertimi	Njesia matese	2022	2023	2024	2025	2023-2025
Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	9,445	9,614	9,825	9,935	29,374
<i>Prodhim vendas</i>	"	5,616	5,954	6,040	6,125	18,119
<i>Energji në marrje</i>	"	3,829	3,660	3,785	3,810	11,255
Energjia totale e transmetuar	GWh	9,239	9,404	9,610	9,715	28,729
<i>Energji elektrike e dhënë</i>	"	1,553	1,614	1,740	1,770	5,124
<i>Energji elektrike për OSHEE sh.a.</i>	"	6,696	6,715	6,720	6,730	20,165
<i>Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar</i>	"	990	1,075	1,150	1,215	3,440
Humbjet në GWh	GWh	207	210	215	220	645
Humbjet në %	%	2.19%	2.19%	2.19%	2.21%	2.20%
Konsumi	GWh	7,686	7,790	7,870	7,945	23,605
C Operuese	Mln leke	7,341	19,166	13,904	11,355	44,424
Energjia	Mln leke	5,351	16,980	11,726	9,134	37,839
- Humbjet	"	4,196	14,116	8,622	5,850	28,589
- Sherbimet Ndihmese	"	906	1,843	2,012	2,120	5,974
- Konxhestion	"	"	720	792	864	2,376
- ITC	"	250	300	300	300	900
Kosto shfrytezimit	Mln leke	1,989	2,236	2,178	2,221	6,585
- Personeli	"	1,330	1,399	1,425	1,454	4,277
- Materiale	"	103	133	143	153	429
- Furnitura & Sherbime	"	557	655	610	614	1,879
Investimet e vitit	Mln leke	3,177	6,496	7,368	3,152	17,016
D - Amortizimi	Mln leke	2,252	2,831	2,930	2,938	8,699
B - Baza e rregulluar e asetëve	Mln leke	35,808	36,733	40,398	44,836	
WACC (sipas Vendimit të ERE për tarifen 2022-2024)	%	2.28%	2.28%	2.28%	2.28%	
R - Kthimi mbi kapitalin (R = B*WACC)	Mln leke	816	838	921	1,022	2,781
C kapital= R+D	Mln leke	3,068	3,668	3,851	3,960	11,480
C - Ardhurat kerkuara (C operuese + C kapital)	Mln leke	10,409	22,834	17,755	15,315	55,904
Te ardhurat nga aktivitetet tjera	Mln leke	1,762	1,433	1,485	1,466	4,384
<i>Ardhura tjera qe zbriten nga te ardhurat e kerkuara</i>	"	1,762	1,433	1,485	1,466	4,384
Ardhurat kerkuara neto	Mln leke	8,646	21,452	16,270	13,848	51,570
Tarifa mesatare e transmetimit	Leke/kWh	1.12	2.75	2.07	1.74	2.18
KOMPONENTET E KOSTOVE NE TARIFEN MESATARE TE TRANSMETIMIT (milione leke)						
<i>Energjia</i>	<i>Mln leke</i>	4,445	15,917	10,745	8,259	34,921
<i>Kosto shfrytezimit</i>	<i>Mln leke</i>	1,652	2,049	1,996	2,008	6,053
<i>Kosto Kapitali</i>	<i>Mln leke</i>	2,548	3,439	3,529	3,581	10,549
KOMPONENTET E KOSTOVE NE TARIFEN MESATARE TE TRANSMETIMIT (leke/kWh)						
<i>Energjia</i>	<i>leke/kWh</i>	0.58	2.04	1.37	1.04	1.48
<i>Kosto shfrytezimit</i>	<i>leke/kWh</i>	0.21	0.26	0.25	0.25	0.26
<i>Kosto Kapitali</i>	<i>leke/kWh</i>	0.33	0.44	0.45	0.45	0.45

*Tarifa mesatare 3 vjeçare e transmetimit perlllogaritet të jete **2.18 leke/kWh***

Duke marrë në konsideratë edhe rregullimin për vitin 2022, tarifa mesatare e transmetimit e kërkuar për periudhën 2023-2025 të jetë **2.20 lekë/kWh**.

IX.2 Llogaritja e Tarifës me dy nivele - Ndarja e kostove në kapacitet dhe energji

i. Pagesat e kapacitetit

Përdoruesit e energjisë elektrike paraqesin një ngarkesë elektrike që ndryshon në çdo cast. Rrjeti elektrik duhet të ndërtohet i tillë që të garantojë shërbimin e energjisë elektrike brenda parametrave teknike dhe të sigurisë në çdo moment të kohës. Llogaritjet për fuqizimin e rrjetit elektrik bëhen për rastin më të rëndë që është ngarkesa e pikut, pra ato varen nga ngarkesa maksimale e konsumatorëve gjatë periudhës llogaritëse dhe jo nga energjia elektrike që ata konsumojnë gjatë kësaj periudhe.

Për këtë, investimet që bëhen për fuqizimin e kapacitetit transmetues të rrjetit elektrik janë funksion i ngarkesës maksimale që paraqesin përdoruesit e këtij rrjeti.

Cdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë kapaciteti në lekë/kW/Muaj, të bazuar në ngarkesën pik gjatë periudhës 12 mujore që mbaron në muajin e faturimit.

Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të kapacitetit janë të barabarta me:

$$C_{kapacitet} = C_{kapital}$$

$$C_{kapacitet} = C_{kapital} + R_{alokimi}$$

R Alokimi Janë të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve nderkufitare të cilat për efekt të llogaritjes së Tarifave të Transmetimit nuk përfshihen në totalin e të ardhurave të kërkuara.

Gjatë 3 viteve të fundit, shuma e kapacitetit total mujor të bazuar në ngarkesën pikë gjatë periudhës 12 mujore për secilin klient të lidhur në rrjetin e transmetimit ka qënë si më poshtë:

Nr.	Subjekti	2019			2020			2021		
		Ora	Data	Kapaciteti (kW)	Ora	Data	Kapaciteti (kW)	Ora	Data	Kapaciteti (kW)
1	EL220-L220KURUM/338	03:00	07/04/2019	57,024	08:00	18/06/2020	58,120	10:00	26/01/2021	59,990
2	F.Arrez-T3/653	17:00	24/03/2019	2,470	19:00	23/01/2020	2,473	20:00	15/08/2021	3,823
3	FERRO KROM-F1(10kV)/342	23:00	11/04/2019	2	09:00	29/01/2020	0	17:00	24/12/2021	380
4	FERRO KROM-F2(10kV)/228	09:00	01/02/2019	572	10:00	20/01/2020	465	09:00	30/12/2021	526
5	FERRO KROM-F3(10kV)/343	01:00	17/07/2019	10,769	20:00	19/07/2020	11,222	21:00	19/01/2021	11,102
6	FERRO KROM-F4(10kV)/229	12:00	19/05/2019	9,604	04:00	17/07/2020	0	16:00	10/09/2021	9,685
7	FUSHE KRUIJE 220kV-T2/058	09:00	22/03/2019	22,545	08:00	11/06/2020	21,823	14:00	02/12/2021	22,244
8	HEC Ashta1-T1/020	05:00	24/09/2019	80	18:00	20/01/2020	58	01:00	14/04/2021	27
9	HEC ASHTA2-T1/213	17:00	05/04/2019	80	18:00	20/01/2020	51	01:00	14/04/2021	75
10	HEC Banje-T1/753	13:00	19/09/2019	15	23:00	11/06/2020	125	10:00	31/05/2021	103
11	HEC Banje-T2/755	17:00	11/08/2019	135	11:00	11/06/2020	127	22:00	31/05/2021	102
12	HEC Fang-T1/544	07:00	08/01/2019	162	07:00	10/01/2020	155	23:00	19/12/2021	140
13	HEC Fang-T2/757	23:00	16/01/2019	169	16:00	24/03/2020	124	21:00	04/04/2021	110
14	Hec Moglice 220kv-T1/182				10:00	07/02/2020	230	21:15	28/12/2021	25
15	Hec Moglice 220kv-T2/184				17:00	06/02/2020	169	02:00	22/02/2021	52
16	Hec Moglice 220kv-T3/751	17:00	05/01/2019	1,780	12:00	24/01/2020	736	19:00	14/02/2021	386
17	HEC Peshqesh-T1/633	03:00	17/01/2019	147	23:00	21/01/2020	135	15:00	19/02/2021	149
18	Lajthiza T1/742				20:00	11/02/2020	817	17:00	14/12/2021	943
19	N/ST 220/6,3COLACENT-T1/336	11:00	08/01/2019	5,884	23:00	02/03/2020	5,760	12:00	08/05/2021	5,722
20	N/ST i AES EL 110kV-T1/690	08:00	13/06/2019	20,080	10:00	03/06/2020	9,824	12:00	22/05/2021	19,284
21	N/ST i AES EL 110kV-T2/692	11:00	05/05/2019	20,412	12:00	13/07/2020	10,952	10:00	22/05/2021	19,759
22	N/ST i GSA EL 110kV-T1/694	03:00	30/08/2019	12,933	10:00	08/07/2020	12,569	13:00	19/07/2021	22,190
23	N/ST i GSA EL 110kV-T2/960									
24	TEC Ballsh-T1/598	14:00	20/08/2019	9,481	02:00	07/02/2020	142	01:00	20/01/2021	128
25	TITAN 220kV-T1/338	09:00	13/07/2019	9,773	18:00	22/02/2020	10,183	10:00	09/10/2021	10,199
26	TITAN 220kV-T2/339	20:00	04/10/2019	9,840	20:00	17/08/2020	9,848	20:00	14/08/2021	10,469
SHUMA E KONSUMATOREVE TE TJERE				193,957		156,108		197,610		
27	OSHEE Group	18.00	09/01/2019	1,332,629	19:00	08/01/2020	1,322,924	18.00	22/12/2021	1,422,462
SHUMA E SISTEMIT				1,526,586		1,479,031		1,620,072		

Duke analizuar situatën elektroenergjitike për vitet 2023-2025, OST sh.a. vlerëson se shuma e kapaciteteve totale të Konsumatoreve të Kualifikuar + OSHEE do të jetë e barabartë me 1,450,000 kW.

Pagesa e kapacitetit në lekë për kW në muaj është e barabartë me:

$$P_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapacitet}} \div L$$

L - shuma e kapacitetit total mujor e treguar në faturat e transmetimit, gjatë 12 muajve të vitit baze

ii. Pagesat e energjisë

Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë për energjinë në lekë/kWh, bazuar në sasinë e kWh të livruar nga sistemi i transmetimit tek klienti i sistemit të transmetimit gjatë atij muaji.

Pagesa e energjisë në lekë për kWh është e barabartë me:

$$P_{\text{energji}} = C_{\text{energji}} \div E$$

Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të energjisë në vitin bazë janë të barabarta me:

$$C_{\text{energji}} = C_{\text{operuese}}$$

E - energjia totale në kWh që do tregohet në faturat e klientit të sistemit të transmetimit gjatë vitit baze

Duke u mbështetur në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit, OST sh.a. ka bere vleresimet sipas tabelës në vijim.


Emertimi	Njesia matese	2022	2023	2024	2025	2023-2025
L Kapaciteti	kW	1,450,000	1,450,000	1,450,000	1,450,000	4,350,000
<i>C kapital = R+D</i>	<i>Mln leke</i>	<i>3,068</i>	<i>3,668</i>	<i>3,851</i>	<i>3,960</i>	<i>11,480</i>
<i>Te ardhurat nga aktivitetet e tjera</i>	<i>Mln leke</i>	<i>1,762</i>	<i>1,433</i>	<i>1,485</i>	<i>1,466</i>	<i>4,384</i>
C kapacitet = C kapital – Te ardhurat nga Alokimi	Mln leke	1,305	2,236	2,366	2,494	7,096
P kapacitet = C kapital / L	Leke/kW/Muaj	75	129	136	143	136
E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)	GWh	7,686	7,790	7,870	7,945	23,605
C Operuese	Mln leke	7,341	19,166	13,904	11,355	44,424
P energji = C operuese / E	Leke/kWh	0.96	2.47	1.77	1.43	1.88

Tarifa mesatare 3 vjeçare sipas komponenteve perlllogaritet të jete:

- Komponenti i kapacitetit: **136 leke/kW/Muaj**
- Komponenti i energjisë: **1.88 leke/kWh**

X. Konkluzionet dhe efektet

Nisur nga përlogaritjet e bëra, në lidhje me tarifë mesatare të nevojshme për periudhen 2023-2025, është bërë një analizë e komponentëve përbërës së tarifës së transmetimit, si me poshte:



Siç vërehet në grafikë, komponenti që ka efektin kryesor në tarifën e transmetimit, ka të bëjë me luhajtjet e çmimit të blerjes së energjisë në treg për humbjet në transmetim dhe shërbimet ndihmëse. Në tarifën mesatare të nevojshme për periudhen 2023-2025, ky komponent rezulton të jetë 1.48 lekë/kWh nga 2.18 leke/kWh, ose 68%.

Duke marrë në konsideratë parashikimet për çmimin e energjisë në treg për vitin 2023 – 559.72 EUR/MWh; për vitin 2024 – 334.19 EUR/MWh dhe për vitin 2025 – 221.60 EUR/MWh, në grafik vihet re qartë ndikimi i kësaj luhajtje në vitet respektive (nga 2.04 leke/kWh në 2023 në 1.04 leke/kWh në 2025).

Komponentet e Kostove kapitale dhe të shfrytezimit, pothuaj ruajnë të njejtin efekt, mesatarisht 0.45 leke/kWh – Kostot kapitale dhe 0.26 leke/kWh kostot e shfrytezimit.


Nga ana e OST sh.a., është vlerësuar dhe janë bërë dhe përlogaritjet përkatëse sipas një varianti i cili merr në konsideratë shtrirjen e efekteve gjatë periudhës 2023-2025, të VKM Nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i cili parashikon sigurimin e humbjeve të energjisë elektrike në transmetim nga ana e KESH sh.a. me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, çmim i cili për vitin 2022 sipas Vendimit të ERE Nr. 253, datë 21.12.2021 është 8.5652 lekë/kWh;

Referuar këtij varianti:

Tarifa mesatare 3 vjeçare e transmetimit perlllogaritjet të jete 1.20 leke/kWh

Në grafikun në vijim, tregohen në mënyrë të përmblëdhur efektet e ndryshimit të çmimit të blerjes së energjisë, duke krahasuar blerjen me çmim tregu me atë që aktualisht OST blen nga KESH sipas VKM.

Efekti i Çmimit të blerjes së energjisë (leke/kWh)




Blerja e energjisë për humbjet me një çmim tregu mesatar për periudhën 2023-2025 prej 369.27 EUR/MWh, në krahasim me çmimin e blerjes nga KESH sipas VKM prej rreth 71 EUR/MWh, ka një efekt në rritjen e tarifës së transmetimit me 0.94 leke/kWh. (nga komponenti i energjisë 0.54 lekë/kWh - me çmim sipas VKM në 1.48 lekë/kWh - me çmim tregu)

Të ardhurat shtesë të nevojshme për aktivitetin e transmetimit, të reflektuar në tarifën e kërkuar, janë rreth 87 milionë EURO/vit dhe për periudhën 3 vjeçare 2023-2025, rreth 260 milionë EURO.

Bazuar në analizen e trajtuar më sipër, për të siguruar operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë dhe lidhjet e interkoneksionit, me qëllimin e sigurimit të një stabiliteti afatgjatë të sistemit si dhe me qëllim të minimizimit të efektit të rritjes së vazhdueshme të tarifës së transmetimit, OST sh.a., propozon miratimin e tarifës mesatare 3 vjeçare të transmetimit në nivelin **2.20 leke/kWh për periudhën 2023-2025**.

Tarifa Mesatare (lekë/kWh)




Të ardhurat nga transmetimi i energjisë elektrike, përbëjnë pjesën kryesore të të ardhurave të kompanisë. Për vitet 2023-2025, Të ardhurat nga transmetimi zënë rreth 92.2% të të ardhurave totale të OST sh.a..

Struktura e të ardhurave nga transmetimi për periudhën 2023-2025, paraqitet në tabelën e mëposhtme:


Konsumatorët	Njesia	2023	2024	2025	2023-2025
OSHEE Group	Mln. Lekë	14,797	14,808	14,831	44,436
Furnizuesit e Kualifikuar	Mln. Lekë	2,369	2,534	2,677	7,581
Të ardhura nga Transmetimi	Mln. Lekë	17,166	17,343	17,508	52,017

Totali i të Ardhurave 2023-2025
(Mln. Lekë)




Pjesën më të madhe të të ardhurave nga transmetimi e zënë të ardhurat e siguruar nga kompanitë e OSHEE Group (FSHU dhe FTL), të cilat zënë rreth 85.4 % të të ardhurave nga transmetimi.

Të Ardhurat nga Transmetimi 2023-2025
(Mln. Lekë)



Efektet e ndryshimit në të ardhurat nga transmetimi sipas ndryshimit të tarifës së transmetimit në vitin e parë, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

Efektet në të ardhurat nga Transmetimi (milionë Lekë)



Rritja e tarifës së transmetimit nga 0.85 leke/kWh që është gjatë vitit 2022 në 2.20 lekë/kWh duke filluar nga viti 2023, reflekton një rritje prej 10.5 miliardë lekë në të ardhurat nga transmetimi ose rreth 159%. Duke mbajtur një tarifë mesatare 3 vjeçare prej 2.20 leke/kWh, të ardhurat nga transmetimi për vitin 2024 dhe 2025 nuk do të kenë rritje për efekt të tarifës gjatë këtyre dy viteve.

OST mbetet në dispozicionin Tuaj për çdo informacion shtesë që mund të kërkohet nga ana Juaj në funksion të përcaktimit të tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për vitet 2023-2025.

Ju faleminderit,

ADMINISTRATORI I OST sh.a.

Skerdi Drenova
Skerdi Drenova

OPERATORI
I SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT